



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 47 regjistër (JR)  
Datë 01.11.2022

Nr. 32 i vendimit  
Datë 24.04.2025

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 24.04.2025, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar z. Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 47/2022 (JR), datë 01.11.2022, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 558, datë 06.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani.

**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, pika 5; neni F, pika 2 e Aneksit i Kushtetutës, ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 63, 64, 65 dhe 66; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet në parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes, Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes:

1. Subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në kuadër të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe (c) Këshilli i Lartë Prokurorisë (në vijim “KLP”), prej të cilave rezultoi se:
  - 2.1. ILDKPKI-ja, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit raportin, duke konstatuar se: (i) deklarami nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor, si dhe mosdeklarim të pasurisë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
  - 2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, ka dërguar raportin, në të cilin ka konstatuar përshtatshmëri për vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Bajram Breçani.
  - 2.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të hartuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt vlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, pasi kreu hetimin e plotë administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përfundim, me vendimin nr. 558, datë 06.09.2022, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Ky vendim është bazuar në përfundimet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

- Për kriterin e vlerësimit të pasurisë [...] Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të paplotë dhe ka mungesë të burimeve financiare lidhur me pasuritë. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për blerjen e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 2.449.229 lekë.

Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasuritë, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

[...] Pra, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti nuk gjendet në kushtet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi deklarimi i pasurive nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Aneksit të Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

- Për kontrollin e figurës, nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

- Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në përfundim, lidhur me kriterin profesional për pesë çështjet e shortuara, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashkrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Lidhur me denoncimet, trupi gjykues konstatoi disa shkelje të subjektit të trajtuar më sipër në këtë vendim, por u konsiderua një rast i vetëm, që nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit lidhur me kriterin e vlerësimit profesional.

## III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit të Komisionit nr. 558, datë 06.09.2022, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani, duke kërkuar përfundimisht konfirmimin e tij në detyrë, me pretendimin se ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të kriterit të pasurisë, vlerësimit profesional dhe të kontrollit të figurës.

5. Subjekti i rivlerësimit ankimin e shoqëroi me disa akte shkresore në cilësinë e provave të reja, të cilat sipas tij i shërbejnë hetimit të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes,<sup>1</sup> duke kërkuar: (i) kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 558 vendimi, datë 06.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Bajram Breçani; (ii) Shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave, duke administruar provat e reja; (iii) Ndryshimin e vendimit nr. 558, datë 06.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Bajram Breçani, dhe konfirmimin në detyrë.
6. Shkaqet procedurale të ankimit që lidhen me procesin e rregullt ligjor, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë si më poshtë:
- 6.1. Subjekti i rivlerësimit në ankim ngre pretendime për shkelje nga ana e Komisionit të një sërë parimesh të procesit të rregullt ligjor, si: parimi i arsytimit të vendimit, parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve, parimi i prezumimit të pafajësisë, parimi i pavarësisë dhe i paanësisë, parimi i ligjshmërisë, parimi i objektivitetit dhe i proporcionalitetit, parimi se ligji nuk ka efekte parapavepruese (zbatimi i ligjit në kohë dhe hapësirë).
- 6.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet që kjo dispozitë kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.
- 6.3. Pretendon gjithashtu se Komisioni ka interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të kuptimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm, si dhe ka cenuar parimin e barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit, pasi ka aplikuar standard të ndryshëm për qëllimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
- 6.4. Sipas subjektit të rivlerësimit, besueshmëria për ligjshmërinë e krijimit të pasurisë nuk mund të jetë një gjendje subjektive e organit që kryen procedimin, por një bindje e krijuar mbi fakte, prova, rrethana objektive, sjellje të subjektit dhe parashikimet e ligjit, vlerësuar në

<sup>1</sup> Subjekti ka paraqitur: (i) prokurë e posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.10.2022, lëshuar nga subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani; (ii) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.10.2022 (11 fletë); (iii) kërkesë drejtuar ASHK-së, e datës 12.10.2022, nga shtetasi A. B., së bashku me aplikimin (5 fletë); (iv) deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.10.2022 (4 fletë); (v) memo, datë 18.07.2022, drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nga A. B., së bashku me dëftesat postare (4 fletë); (vi) aplikim pranë ASHK-së, datë 21.10.2022, së bashku me mandatarkëtimin përkatës, kryer nga Bajram Breçani (5 fletë); (vii) plan rilevimi për punime kadastrale, i datës 21.10.2022, me objekt pjesëtim pasurie (1 fletë); (viii) shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2022, së bashku me praktikën përkatëse, e noterizuar (gjithsej 22 fletë); (ix) vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*}, datë 09.05.2022, i deklaratës noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.10.2016 (6 fletë); (x) shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 14.07.2022, i Ministrisë së Financave, e noterizuar dhe vërtetimi i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 17.10.2022 (3 fletë); (xi) mandatpagesat e viteve 1995 – 1996, e fondacionit bamirës “{\*\*\*}”, njësuar me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 24.10.2022 (tetë fletë); (xii) certifikatë regjistrimi e pronësisë, datë 21.10.2022, për pasurinë nr. {\*\*\*} ND+{\*\*\*}, në pronësi të shtetasit A. B. (4 faqe); (xiii) vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 24.10.2022, i urdhrit nr. {\*\*\*}, datë 21.10.2022, “Për korrigjimin e emrit të lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 17.09.2020 dhe certifikatës së pronësisë me nr. pas. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, z. k. {\*\*\*}”, lëshuar më datë 22.09.2020, në emër të Bajram e B. Breçani, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug (3 fletë); (xiv) vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 24.10.2022, i aktekspertimit të inxhinieres E. L. (50 faqe); (xv) vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 24.10.2022, i statement-it bankar nga BKT (21 fletë); (xvi) vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 24.10.2022, i vërtetimit të lëshuar për A. B., D. B. dhe D. B. (7 fletë).

tërësinë e tyre në mënyrë objektive dhe të paanshme, si dhe në përputhje me kriteret e objektivitetit dhe proporcionalitetit, si dhe në respektim të parimit të barazisë para ligjit.

6.5. Subjekti pretendon se Komisioni ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit, si një prej aspekteve të procesit të rregullt ligjor, duke qenë se nuk është shprehur për një pjesë të argumenteve të paraqitura prej tij. Standardi i arsytimit të vendimit kërkon që të shqyrtohen me rigorozitet të veçantë argumentet kryesore të palëve, arsytimi i Komisionit mbart mungesa thelbësore të fakteve dhe të ligjit apo edhe shtrembërim të tyre.

6.6. Gjithashtu, subjekti pretendon se arsytimi i vendimit nga Komisioni përmban haptazi zbatim të pasaktë e të gabuar të ligjit në fuqi, që shfaqet në formën e abstragimit faktik e ligjor apo edhe në formën e argumenteve alogjike, apo edhe e sajimit të rregullave që nuk ekzistojnë. Komisioni ka bërë analizë të refuzimit të argumentit të tij tërësisht abstrakte dhe të pakuptueshme, duke përdorur terminologji të papërshtatshme dhe të paqartë, për të justifikuar shmangien nga zbatimi i drejtë i ligjit.

7. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

7.1. Në lidhje me pasurinë “shtëpi banimi 145 m<sup>2</sup>” dhe “truall 460 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se këtë pasuri e ka në bashkëpronësi me dy vëllezërit e tij dhe se ajo është ndërtuar me kontributin e të treve. Subjekti pretendoi se ai ka pasur burime financiare të ligjshme për ndërtimin e pjesës së tij takuese.

7.2. Në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, blerë në vitin 2003, në vlerën 200.000 lekë, subjekti pretendon se, përkundër konkluzionit të Komisionit, në lidhje me çmimin e kësaj pasurie, çmimi i shitjes, prej 430.000 lekësh, në vitin 2009, nuk është fiktiv dhe se veprimet juridike të kryera nga ana e tij janë konform me ligjin, dhe se në kohën e shitjes së kësaj pasurie nuk ka pasur detyrimin për të paguar tatim mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie.

7.3. Në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa {\*\*\*}, blerë në vitin 2009, në vlerën 9.000 euro, subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën financiare duhet të përfshihen vlera sipas çmimit të shitjes së automjetit me targa {\*\*\*}, kursimet e tij nga paga dhe huat e akorduara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, çka do të përmbyste rezultatin negativ në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

7.4. Në lidhje me automjetin tip “DaimlerChrysler”, me targa {\*\*\*}, blerë në vitin 2015, nga djali i subjektit të rivlerësimit, me vlerë 450.000 lekë, subjekti pretendon se në analizë duhet të përfshihen të ardhurat nga shitja e automjetit me targa {\*\*\*} dhe nga punësimi i djalit, për periudhën 01.11.2011 – 27.04.2015, çka do të sillte përmbysjen e konkluzionit të Komisionit, për mungesë të burimeve financiare të ligjshme lidhur me këtë pasuri.

7.5. Në lidhje me analizën financiare për vitet 1995 – 2000, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për bilanc negativ dhe pretendon se analiza duhet kryer në mënyrë kumulative.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Bajram Breçani, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### b) Legjitimimi i ankuesit

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 558, datë 06.09.2022, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”), në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
11. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çelje të hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë:

11.1. Sa u takon akteve shkresore që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit të tij, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se, pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues, mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi se aktet shkresore të dorëzuara së bashku me ankimin, nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces, referuar dispozitave të sipërcituara ligjore dhe, për rrjedhojë, nuk u administruan në cilësinë e provës nga trupi gjykues.

11.2. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrollon zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në Kolegj për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit.

*B. Vlerësimi i trupit gjykues mbi shkaqet procedurale të ankimit*

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se janë shkelur një sërë parimesh të procesit të rregullt ligjor, si: parimi i arsytimit të vendimit, parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve, parimi i prezumimit të pafajësisë, parimi i pavarësisë dhe i paanësisë, parimi i ligjshmërisë, parimi i objektivitetit dhe i proporcionalitetit, parimi se ligji nuk ka efekte prapavepruese (zbatimi i ligjit në kohë dhe hapësirë). Në lidhje me këto pretendime, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka pretenduar shkeljen e këtyre parimeve në mënyrë të përgjithshme, pa parashtruar shkeljen e tyre të lidhur me fakte dhe rrethana konkrete gjatë procesit të tij të rivlerësimit në Komision, duke pamundësuar kështu kontrollin e Kolegjit ndaj këtyre shkeljeve të pretenduara të subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, këto pretendime nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkakut konkret ankimi.
13. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kriterëve, pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues çmon të risjellë në vëmendje se Kolegji ka jurisprudencë të konsoliduar<sup>2</sup> në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vlerësimi për secilin kriter rivlerësimi është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, ky pretendim është i pabazuar në ligj.
14. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Komisioni ka interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të kuptimit të konceptit të deklaramentit të pamjaftueshëm, trupi gjykues vlerëson se, në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën e tij, koncepti i deklaramentit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet në raport me konstatimet e procesit të vlerësimit të pasurisë sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramentit të pamjaftueshëm. Parashikimet e kësaj pike të nenit nuk vlerësohen në raport me njëra-tjetrën, por shihen si të pavarura, vlerësimi i të cilave mund të prodhojë pasojën ligjore sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar.
15. Në vlerësimin e pretendimit të subjektit, se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit, pasi ka aplikuar standard të ndryshëm për zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmoi se Kolegji, brenda juridiksionit dhe kompetencës së

<sup>2</sup> Vendimet e Kolegjit nr. 9/2018 (JR); nr. 7/2019 (JR); nr. 15/2019 (JR) dhe nr. 24/2020 (JR).

tij kushtetuese<sup>3</sup>, shqyrton ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit vetëm për shkaqet e pretenduara prej tij, të cilat lidhen me vendimin e Komisionit objekt ankimi dhe jo me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendime të tjera, për subjekte të tjera rivlerësimi. Pretendimi i subjektit, se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë para ligjit, si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar me standarde të dyfishta, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit, nuk mund të përbëjë *apriori* arsye për të konsideruar të padrejtë vendimin e Komisionit.

16. Në vlerësim të pretendimit të subjektit, se Komisioni ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit, si një prej aspekteve të procesit të rregullt ligjor, duke qenë se nuk është shprehur për një pjesë të argumenteve të paraqitura prej tij, trupi gjykues vëren se subjekti e lidh pretendimin e tij me argumentin se në vendim ka një sërë gabimesh dhe referencash të gabuara, nuk është bërë vlerësimi i të gjitha fakteve që qëndrojnë në themel të procesit, si dhe disa konkluzione, të cilat nuk i janë komunikuar subjektit, nuk mbështeten në prova. Po ashtu, subjekti pretendon se arsytimi i vendimit përmban haptazi zbatim të pasaktë e të gabuar të ligjit, që shfaqet në formën e abstragimit faktik dhe ligjor apo edhe në formën e argumenteve alogjike dhe të sajimit të rregullave që nuk ekzistojnë. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka bërë analizë të refuzimit të argumenteve të tij dhe, duke përdorur terminologji të papërshtatshme e të paqartë, ka kërkuar të justifikojë shmangien nga zbatimi i drejtë i ligjit. Sa më sipër, nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se, për secilën pasuri të hetuar, parashtrihen si fillim rrethanat e faktit, duke pasqyruar në mënyrë të përmbledhur shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit, si dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ. Më tej, në rubrikën “Qëndrimi i subjektit” parashtrihet në mënyrë të përmbledhur qëndrimi i subjektit dhe provat e paraqitura prej tij pas kalimit të barrës së provës, dhe në rubrikën “Vlerësimi i Komisionit” rezultojnë të jetë parashtruar analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe konkluzionin nëse kanë mundur ose jo të përmbysin barrën e provës. Fakti që në vendimin e Komisionit nuk janë cituar në mënyrë analitike të gjitha shpjegimet apo aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk nënkupton apo provon mungesë analize të shpjegimeve dhe akteve. Përkundrazi, trupi gjykues vëren se Komisioni ka mbajtur qëndrim duke argumentuar faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë dhe të argumentojë deri në atë masë sa të përmbysë barrën e provës, çka dëshmon në vetvete se provat e paraqitura prej tij i janë nënshtruar një procesi analize e vlerësimi nga ana e trupit gjykues. Fakti se Komisioni ka bërë një vlerësim të ndryshëm të tyre, nga pritshmëritë dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nuk tregon se ka munguar vlerësimi për to. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi arsytimin e vendimit vlerësohet se nuk qëndrojnë. Sa i takon pretendimeve të subjektit për gabime dhe referenca të gabuara në vendim, si dhe pretendimeve për konkluzione të Komisionit, të cilat nuk i janë komunikuar subjektit, trupi gjykues vlerëson se ato janë objekt vlerësimi dhe kontrolli sipas shkaqeve konkrete të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

*C. Vlerësimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë*

17. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit, për deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme

---

<sup>3</sup> Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës: “5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...]”.

për të justifikuar blerjen e pasurisë “truall” dhe ndërtimin e objektit (pjesën takuese), *shtëpi banimi, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë*, trupi gjykues konstatoi si vijon:

17.1. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve dhe kontrollin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, ka arritur në konkluzionin se: *Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë “truall” dhe ndërtimin e objektit (pjesën takuese), duke mos u gjendur në kushtet e përcaktuara në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, subjekti është gjendur në kushtet e përcaktuara nga germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare të ligjshme për këtë pasuri. Këtë konkluzion, Komisioni në vendimin e tij e ka bazuar në arsyetimin se:*

(i) Subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, që Komisioni i kaloi në përfundim të rezultateve të hetimit për këtë pasuri dhe se qëndrimet dhe prapësimet e tij mbetën në nivel deklarativ dhe nuk shoqërohen me dokumentacion ligjor provues.

(ii) Pasuria “truall” rezultoi se është regjistruar në emër të dy bashkëpronarëve, subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij, B. B., përkatësisht në  $\frac{1}{2}$  pjesë, të cilët rezultojnë edhe sot bashkëpronarë të pasurisë me sipërfaqe totale 671.2 m<sup>2</sup> truall dhe 150.5 m<sup>2</sup> ndërtesë.

(iii) Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor përfshirjen e vëllait tjetër, A. B., dhe kontributin e tij si bashkëpronar në pasurinë “truall” dhe “objekt”, dhe as nuk rezultoi që të ishte ndërmarrë ndonjë veprim ligjor për përfshirjen e tij në procesin e legalizimit dhe më pas të regjistrimit të kësaj pasurie në emër të të tre bashkëpronarëve, që nga momenti i krijimit të pasurisë dhe as që nga deklaratat *vetting* (e vitit 2017), deri më sot.

(iv) Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2013, si dhe në kërkesën e bërë për legalizim pranë ALUIZNI-t, subjekti nuk e ka deklaruar përfshirjen e vëllait A. B. si përfitues dhe kontribues në blerjen e pasurisë “truall” dhe ndërtimin e objektit, si bashkëfinancues (për rrjedhojë, edhe si bashkëpronar), si dhe ka pranuar se ka bërë deklaram të pasaktë të kësaj pasurie në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2013, pranë ILDKPKI-së.

(v) Subjekti nuk arriti të provojë kontributin e vëllait A. B. për blerjen dhe ndërtimin e objektit dhe as mundësinë financiare të tij, dhe deklaratat se shtetasi A. B. ka qenë posedues i katit të tretë të pasurisë bie në kundërshtim me deklaramet e subjektit, pasi sipas përgjigjes në pyetësorin nr. 2 është deklaruar se z. A. B. ka banuar dhe banon në qytetin e Bajram Currit dhe kati i tretë i objektit, për të cilin ai mund të këtë kontribuar, është i pabanueshëm.

(vi) Komisioni ka vlerësuar se vlera e investimit për këtë pasuri do të konsiderohet sa 50% ( $\frac{1}{2}$  bashkëpronësi) e vlerës së deklaruar prej subjektit në deklaratën *vetting* (edhe në deklaratën para fillimit të detyrës). Vlera e investimit total në objektin ndërtimor të deklaruar në deklaratën e pasurisë është 8.000.000 lekë, ku pjesa takuese e subjektit u llogarit nga Komisioni ( $\frac{1}{2}$  pjesë) në vlerën 4.000.000 lekë.

(vii) Në lidhje me shpenzimet e arredimit, mobilimit dhe përshtatjes, Komisioni i vlerësoi në përputhje me deklaramin e subjektit në deklaratën *vetting*, në shumën 2.500.000 lekë dhe vlera e shpenzimeve të punimeve të brendshme, mobilimit dhe përshtatjes, deri në vitin 1998, është 1.200.000 lekë.

(viii) Në lidhje me burimet financiare, Komisioni, në analizën përfundimtare ka marrë në konsideratë edhe të ardhurat e subjektit të përfituara nga fondacioni “{\*\*\*}”, në shumën 500.000 lekë dhe 825.000 lekë, ndërsa në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit gjatë

procesit, se si burim kanë shërbyer edhe kursimet ndër vite, ato nuk janë përfshirë në analizën financiare, me arsyetimin se nuk janë deklaruar si të tilla në deklaratën *vetting*, por edhe për arsye se, duke iu referuar analizës financiare të viteve 1995 – 1998, subjekti i rivlerësimit rezulton me pamundësi financiare, duke mos pasur mundësi kursimi.

17.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri, duke pretenduar përfshirjen e vëllait A. B. në kontributin financiar për investimin e saj, pasi sipas tij, trualli është blerë prej tij dhe vëllait B. B., ndërsa banesa trekatëshe është ndërtuar me kontributet e të tre vëllezërve, secili për pjesën takuese. Më konkretisht, ai vetë dhe vëllai B. B. kanë kontribuar në vlerat 3.000.000 lekë secili, ndërsa vëllai tjetër A. B. në vlerën 2.000.000 lekë. Këtë shkak ankimi, subjekti e mbështeti në pretendimet e mëposhtme:

(i) Në deklarinimin për legalizim nuk është përmendur emri i vëllait A. B., pasi në momentin e dorëzimit të vetëdeklarimit për legalizim pranë ALUIZNI-it, ai nuk ka qenë në Tiranë, por në qytetin e Bajram Currit. Vetëdeklarimi është kryer në vitin 2006, periudhë gjatë së cilës nuk ishte subjekt rivlerësimi. Duke qenë se ishte marrëdhënie mes vëllezërish, së bashku me vëllain B. B. plotësuan formularin, ndërsa në lidhje me përfshirjen e vëllait tjetër, A. B., punonjësit e ALUIZNI-t i sqaruan se kjo mund të bëhej lehtësisht më vonë, me anë të një deklaratë noteriale.

(ii) Në vitin 2016, ndërkohë që procesi i legalizimit nuk kishte përfunduar, ata si vëllezër kanë paraqitur pranë ALUIZNI-t një deklaratë noteriale me qëllim që secili të merrte pjesën e tij takuese. Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.10.2016, e depozituar pranë ALUIZNI-t nga ana e tyre si bashkëpronarë *de facto*, vërteton kontributin e të tre vëllezërve për ndërtimin e objektit. Kjo procedurë, e ndërmarrë në mënyrë zyrtare pranë ALUIZNI-t, nuk ka marrë përgjigje nga ky institucion, i cili nuk ka vepruar për regjistrimin e deklaratës noteriale. Ky fakt, sipas subjektit, provohet sipas shkresës “Kthim përgjigje” nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2022, të ASHK-së, Drejtoria Rajonale Tiranë, provë shkresore brenda së cilës ndodhen edhe prova të tjera të rëndësishme, të cilat provojnë në mënyrë të qartë se investitorë në këtë objekt janë ai dhe dy vëllezërit e tij, secili me  $\frac{1}{3}$  pjesë takuese.

(iii) Nga ana e Komisionit është administruar edhe deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.10.2016, “Për njohje shpenzimesh financiare”, nënshkruar dhe hartuar përpara plotësimit të deklaratës *vetting*, për këtë arsye, Komisioni nuk mund të nënvlerësonte akte të tilla ligjore vetëm me argumentin se janë të karakterit deklarativ. Referuar shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2022, të ASHK-së, vetë ky institucion pranon se deklarata noteriale e vitit 2016 nuk është marrë parasysh nga ana e tyre, për shkak se trualli është në pronësi të Bajram dhe B. Breçani, por nga ana tjetër, z. A. B. nuk i mohohet e drejta për të qenë pronar, duke sqaruar se, në momentin që z. A. B. do të bëhet bashkëpronar i truallit ku ndodhet ky objekt, nga ana e tyre do të merren masa që të regjistrohet si bashkëpronar edhe në objektin e legalizuar.

(iv) Së bashku me deklarinimet periodike, pranë ILDKPKI-së ka paraqitur dhe dy deklarinimet e vëllezërve, të cilët deklaronin faktin e bashkinvestimit, secili sipas pjesës takuese dhe të ardhurat e përdorura prej tyre për ndërtimin e objektit, që nuk janë administruar nga ana e këtij institucioni, me arsyetimin se ata nuk ishin persona të lidhur.

(v) Ai nuk ka deklaruar asnjëherë se pronësia mbi truallin i përket të tre vëllezërve, por se në objektin trekatësh, një prej kateve është investuar prej vëllait të tij (A.), për të pasur secili nga një kat. Sipas subjektit, një koncept i tillë është më se i pranueshëm dhe ndodh shpesh në familjet shqiptare, ku vëllezërit kontribuojnë të ndërtojnë bashkërisht shtëpi banimi. Vëllai, A. B., ka kryer të njëjtin deklarinim, si dhe ka paraqitur një memo individuale përpara Komisionit, duke kërkuar edhe thirrjen e tij në cilësinë e dëshmitarit.

(vi) Në zbatim të rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe Kodit të Procedurës Civile mbi vlerësimin e provave, deklaratat noteriale të përpiluara përpara noterit janë akte zyrtare dhe përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara noterit, si nëpunës i cili ushtron veprimtari publike me kompetencë për hartimin e deklaratave noteriale sipas ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”.

(vii) Deklaratat noteriale nuk janë provat e vetme për ekzistencën e fakteve juridike që kanë passjellë këtë marrëdhënie mes vëllezërish, pasi nga ana e subjektit, me kërkesën e datës 12.10.2022,<sup>4</sup> ka kërkuar korrigjimin e lejes së legalizimit të datës 20.09.2020 dhe certifikatave të pronësisë, duke saktësuar pjesët përkatëse të bashkëpronësisë mbi banesën e investuar nga të tre vëllezërit. Po ashtu, subjekti pretendon se, me urdhër të drejtorit të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug, si dhe me kërkesën e tyre për ndarje pasurie, është trajtuar dhe saktësuar marrëdhënia e pronësisë për pasurinë në fjalë.

(viii) Kjo marrëdhënie, sipas subjektit të rivlerësimit, mbështetet edhe nga deklaratat noteriale të vëllait, A. B., si dhe nga deklarata noteriale e datës 21.10.2022,<sup>5</sup> lëshuar nga bashkëshortja dhe fëmijët e subjektit, ku të gjithë deklaruesit kanë shprehur dakordësinë për ndarjen e pasurisë së llojit “truall” dhe “ndërtesë”.

(ix) Deklarimi në deklaratën para fillimit të detyrës është bërë në përputhje me formularin e vetëdeklarimit të ALUIZNI-t, pasi në atë kohë, për shkak edhe të mungesës së eksperiencës në plotësimin e deklarimit të pasurisë, nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur këtij fakti dhe e ka pasqyruar gjendjen sipas dokumentacionit dhe jo sipas gjendjes reale të bashkëpronësisë në objekt. Mosdeklarimi i përfshirjes së vëllait të tij në pjesët takuese të ndërtimit, edhe nëse do të konsiderohet pasaktësi, është tërësisht i paqëllimshëm dhe trajtimi i tij, ndryshe nga ana e Komisionit, bie ndesh me vetë frymën e reformës në drejtësi dhe qëndrimet e unifikuara të Kolegjit, sipas të cilave, pasaktësitë në deklarime nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkim, për sa kohë që nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme financiare.

18. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë periodikë (në vijim “DIPP”), trupi gjykues konstaton se, lidhje me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* deklaroi:

- Disponoj një shtëpi banimi me sip. 145 m<sup>2</sup>, sipërfaqe trualli 460 m<sup>2</sup> dhe një pjesë shpati rreth 300 m,<sup>2</sup> në pjesën lindore, e konfirmuar nga kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.06.1998, e përbashkët me vëllezërit, blerë pronarëve H. dhe M. B., në fund të vitit 1995, pa dokumente ligjore dhe e kthyer me dokumente ligjore sipas kontratës së blerjes më 16.6.1998, në vlerën 368.000 lekë. Pasuri e regjistruar në ZVRPP, më 22.6.1998. Burimi i të ardhurave është nga të tre vëllezërit, ku pjesa takuese është afërsisht 123.000 lekë, burimi i të ardhurave janë dokumentet justifikuese të poshtëshënuara. Trualli, banesa dhe muri rrethues ndodhen në Z. K. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, nr. rendor {\*\*\*}, rruga ‘{\*\*\*}’, Tiranë. Kjo banesë ndodhet në godinën trekatëshe, tre hyrjesh, për të cilën është shpenzuar shuma 8.000.000 lekë në total

<sup>4</sup> Në aktet bashkëlidhur ankimit, SR ka paraqitur kërkesë (formular) nr. {\*\*\*}, datë 21.10.2022, ku është depozituar dokumenti “Kontratë pjesëtimi ose vendim gjykate”, i datës 21.10.2022, shoqëruar me plan rilevimi të përgatitur nga subjekti privat Gj. B., më datë 21.10.2022, me qëllim “pjesëtim pasurie”. Kërkesa e datës 12.10.2022, drejtuar ASHK-së, ku kërkohet korrigjimi i lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 20.09.2020, është bërë nga vëllai i subjektit, A. B., dhe shoqërohet me kërkesë (formular) nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2022, për depozitim të saj.

<sup>5</sup> Është e paqartë së cilës deklaratë i referohet SR-ja, pasi, bashkëlidhur ankimit, SR-ja ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., të datës 21.10.2022, ku deklarues janë Bajram Breçani, H. B., B. B. dhe R. B.

dhe është ndërtuar me kontributet e mia dhe të vëllezërve të mi, A. U. B. dhe B. U. B., i cili, nga viti 1993 – 1996, ka qenë emigrant në Firenze, Itali. Objekti trekatësh është i ndarë me pjesë të barabarta prej 33.3% secili. Unë, për ndërtimin e kësaj banese, kam shpenzuar 3.000.000 lekë dhe për rregullimin dhe mobilimin rreth 2.500.000 lekë. Ndërtimi i kësaj banese ka filluar në fundin e vitit 1996, fillimviti 1997.

- Burimi i të ardhurave për ndërtimin e pjesës takuese të banesës janë: Shitja e banesës me kontratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 16.1.1997, në vlerën 2.000.000 lekë (banesë e cila ka qenë në bashkëpronësi me vëllain tim, B. U. B., me pjesë takuese 50% me 50%, që do të thotë 1.000.000 lekë të reja secili prej nesh. Sqaroj se banesa e shitur me kontratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 16.1.1997, është blerë prej meje dhe vëllait B. U. B., në shumën 1.650.000 lekë, me kontratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 29.01.1996, me pjesë takuese 50% me 50%, e konvertuar në 825.000 lekë, nga të cilat, shuma prej 675.200 lekësh është e siguruar nga të ardhurat e fondacionit “{\*\*\*}”, sipas mandatpagesave (në datat 22.11.1995, 03.07.1995, 30.08.1995), duke respektuar normat ligjore, të njohura nga shteti shqiptar, mbi bazën e të cilave funksiononte ky fondacion. Ndërsa, pjesa prej 149.800 lekësh është paguar nga vëllai im B. U. B., njëkohësisht dhe bashkëpronar në këtë banesë. Këtë shumë ia kam kthyer vëllait me shitjen e kësaj banese, pasi nga kjo shitje kemi fituar shumën 350.000 lekë të reja. Gjithashtu, burim i krijimit të të ardhurave për ndërtimin e pjesës takuese në banesën private me sip. prej 145 m<sup>2</sup>, truallit dhe murit rrethues të banesës është aktmarrëveshja nr. {\*\*\*} i regj., datë 12.03.1997, që përcakton shitjen e banesës shtetasit A. Ll. C., në Lushnjë, lagjia “{\*\*\*}”, kontratë noteriale shitjeje nr. {\*\*\*}, datë 06.09.2001. E ardhur tjetër e shfrytëzuar për ndërtimin e banesës dhe murit rrethues është edhe shuma prej 500.000 lekësh, që vjen nga mandatpagesa nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, nga fondacioni “{\*\*\*}”, i njohur nga ligji shqiptar i asaj kohe, veprimet kontraktuese nga ana ime me këtë fondacion janë kryer sipas ligjit dhe statutit që mbante ky fondacion. Sqaroj se i kam marrë vëllait tim, B. U. B., huan në shumën 600.000 lekë, të cilën e kam kthyer në vitin 2003, para të ardhura nga kursimet e mia të pagës dhe kreditë e marra nga PSHM-ja dhe sot e quajtur NOA.

- Në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2013, subjekti ka deklaruar: “Shtëpi banimi 3 kate, me sip. 145 m<sup>2</sup> x 3, e ndodhur në rrugën ‘{\*\*\*}’, e ndërtuar në bashkëpronësi me vëllain, në vitin 1996, me të ardhura nga shitja e apartamenteve të mëparshëm në Bajram Curri dhe Lushnjë, si dhe të ardhurat e vëllait emigrant në Itali (në proces legalizimi). Vlera 8.000.000 lekë, pjesa 50%”.

- Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, subjekti ka deklaruar: “Nga data e fillimit të detyrës, 30.11.2013, si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kam banuar në banesën time private, e cila ndodhet në rrugën ‘{\*\*\*}’, pranë {\*\*\*}, në Njësinë Bashkiake Nr. {\*\*\*}, Tiranë, e cila ka një sipërfaqe prej 145 m<sup>2</sup>, ndërtim dhe ndodhet në një truall prej 450 m<sup>2</sup>, të cilin e kam në bashkëpronësi me vëllezërit e mi, shtetasit A. dhe B. B. Sqaroj se pjesa ime takuese prej 145 m<sup>2</sup> ndodhet në objektin trekatësh, të ndërtuar së bashku me dy vëllezërit e mi, ku secili prej nesh disponon të njëjtën sipërfaqe ndërtimi”.

- I pyetur nga Komisioni në lidhje me faktin se, në deklarimin për legalizim, si dhe në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2013, nuk deklarohet emri i vëllait A. B. si bashkëkontribues/bashkinvestues në ndërtimin e banesës, subjekti ka sqaruar se: “Në lidhje me faktin se në deklarimin për legalizim nuk është përmendur emri i vëllait tim, shtetasit A. B., pasi ai nuk ishte në Tiranë, por në qytetin e Bajram Currit në momentin e hartimit dhe dorëzimit

të vetëdeklarimit për legalizim pranë ALUIZNI-t (sqaroj se vetëdeklarimi është dorëzuar në vitin 2006 dhe unë në atë kohë nuk isha subjekt rivlerësimi). Duke qenë se kjo është një marrëdhënie ndërmjet vëllezërish, së bashku me vëllain tjetër plotësuam formularin, dhe në lidhje me përfshirjen e vëllait A. B. në vetëdeklarim, punonjësit e ALUIZNI-t na sqaruan se kjo mund të bëhej lehtësisht më vonë me anë të një deklarate noteriale. Gjithashtu, në deklaratën para fillimit të detyrës, deklarimi është bërë në përputhje me formularin e vetëdeklarimit të ALUIZNI, pasi në atë kohë, për shkak edhe të mungesës së eksperiencës në plotësimin e deklarimit të pasurisë, nuk i kam kushtuar rëndësinë e duhur këtij fakti dhe kam pasqyruar gjendjen sipas dokumentacionit provues që kisha dhe jo gjendjen reale të bashkëpronësisë në objekt. Tokën e kemi blerë unë dhe vëllai im, B. B. Vëllai tjetër, A. B., na ka kërkuar që të ndërtonte një kat, edhe ai në objektin që ne po ndërtonim dhe ne kemi rënë dakord që ta lejojmë të ndërtojë katin e tretë të objektit. Bashkëlidhur po ju dërgoj një kopje të deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.10.2016.

- Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, përveç sqarimeve të dhëna në pyetësorin nr. 2, subjekti ka deklaruar se i është drejtuar ASHK-së me kërkesë për informacion në lidhje me përfshirjen në procesin e legalizimit të vëllait të tij, A. B. dhe, në përgjigjen e saj nr. {\*\*\*} prot, datë 18.07.2022, ASHK-ja konfirmon se, gjatë verifikimit në terren nga ana e punonjësve të ALUIZNI-t, është konstatuar se objekti posedohej nga Bajram Breçani, B. B. dhe A. B. Sipas subjektit, ASHK-ja konfirmon gjithashtu se ka administruar deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.10.2016, ku deklarohet se të tre vëllezërit kanë investuar së bashku për ndërtimin e objektit, e megjithatë, kjo deklaratë nuk është marrë në konsideratë, për arsye se trualli është në pronësi të Bajram e B. B., por, po sipas përgjigjes së ASHK-së, atij nuk i mohohet e drejta e pronësisë dhe, në momentin që do të bëhet bashkëpronar mbi sipërfaqen e truallit, nga ana e tyre do të merren masa që ai të bëhet bashkëpronar edhe në objektin e legalizuar.

- Gjatë hetimit në Komision është administruar dhe shqyrtuar: (a) dokumentacioni bashkëlidhur deklaratës *vetting* në lidhje me praktikën e legalizimit nr. {\*\*\*}, në vitin 2006<sup>6</sup>; (b) dokumentacioni shkresor i përcjellë nga ALUIZNI, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 24.08.2017, drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana Jug, për dëgjimi ILDKPKI-së, mbi praktikën e vetëdeklarimit në emër të Bajram Breçani dhe B. B.<sup>7</sup>; (c) shkresa e ASHK-së nr. {\*\*\*} prot., datë 22.07.2020, drejtuar Komisionit<sup>8</sup>.

---

<sup>6</sup> Vërtetim pronësie, lëshuar nga ZVRPP Tiranë, më 22.06.1998; Kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2016, nga ZVRPP Tiranë; Kartela e pasurisë së paluajtshme, e llojit "truall" me sipërfaqe 460 m<sup>2</sup>; Kontratë shitblerje trualli, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.06.1998; Vërtetim pronësie, datë 22.06.1998, nga hipoteka Tiranë, për pasurinë "truall" 460 m<sup>2</sup>; Kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, nr. {\*\*\*}, datë 17.11.2016, në lidhje me të dhënat e vetëdeklarimit për legalizimin e objektit, bashkëlidhur së cilës gjenden: Vetëdeklarimi nr. {\*\*\*}, datë 17.08.2006; Certifikatë e përbërjes familjare e Barjam U. Breçani; Certifikatë e përbërjes familjare e B. U. B.; Kontratë shitblerje trualli nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.06.1998; Vërtetim pronësie, datë 22.06.1998, nga hipoteka Tiranë për pasurinë "truall" 460 m<sup>2</sup>; Planvendosje e pronës së B. e Bajram Breçani, me datë 13.07.1999; Fotografi të objektit të përfunduar.

<sup>7</sup> I cili përmban: - Relacionin tekniko-ligjor për kualifikim objektësh për legalizim, i datës 17.08.2008; - Vetëdeklarim për legalizimin e objektit "banesë"; - Certifikatat familjare të dy familjeve, Bajram e B. B.; - Planvendosje e pronës, që mban datën 13.07.1999; - Kontrata e blerjes së truallit ku është ndërtuar objekti, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.06.1998; - Vërtetim pronësie mbi truallin, datë 22.06.1998, nga Hipoteka Tiranë; - Fotografi të objektit.

<sup>8</sup> Bashkëlidhur së cilës ndodhen: - Kartela e pasurisë së paluajtshme për truall 460 m<sup>2</sup>; - Vetëdeklarim për legalizimin e objektit "banesë", nr. {\*\*\*}, datë 17.08.2006; - Certifikatat familjare të dy familjeve Breçani; -

19. Në këndvështrim të të dhënave të referuara më sipër, trupi gjykues analizozi pretendimet e subjektit lidhur me konstatimin e Komisionit sa i takon mospërfshirjes së vëllait A. B. si bashkëkontribues/bashkinvestues në ndërtimin e banesës, duke konstatuar si vijon:

19.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përfshirjen e vëllait të tij, A. B., në asnjë prej dokumenteve deklaruese të legalizimit të ndërtimit objekt shqyrtimi pranë ALUZNI-t dhe as në deklaratën para fillimit të detyrës (në vijim “DPFD”), të vitit 2013. Kërkesa për legalizim pranë ALUIZNI-t dhe dokumentacioni shoqërues, si dhe leja e legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 17.09.2020, si dokumenti zyrtar që finalizon procedurat e legalizimit të ndërtimit informal, nuk përmbajnë fakte që lidhen me përfshirjen e vëllait A. B. si bashkëkontribues në blerjen e pasurisë “truall” apo në ndërtimin e objektit ose si posedues i katit të tretë, sikurse ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*.

19.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti rezulton të ketë paraqitur praktikën shkresore të Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana Jug, nr. {\*\*\*} prot., datë 17.11.2016, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, si përgjigje e kërkesës së vetë subjektit për saktësimin e të dhënave të vetëdeklarimit, sipas të cilës konfirmohet se, në praktikën e legalizimit nr. {\*\*\*} prot., viti 2006, që administrohet pranë tyre, në të dhënat e deklarimit figurojnë të dy shtetasit Bajram U. Breçani dhe B. U. B. Trupi gjykues konstaton se kjo shkresë shoqërohet me dokumentacionin që disponohej nga ky institucion në lidhje me procedurën e legalizimit dhe që përfshin: formularin e vetëdeklarimit nr. {\*\*\*}, datë 17.08.2006, certifikatën e përbërjes familjare të Bajram Breçani, certifikatën e përbërjes familjare të B. B., kontratë shitblerje truall, vërtetim pronësie mbi truallin, planvendosje e pronës në emër të Bajram e B. B., si dhe disa fotografi të objektit të përfunduar, ku nuk rezulton të jetë referuar në ndonjë rast përfshirja e vëllait tjetër të subjektit si bashkëposedues apo bashkinvestitor i këtij objekti. Po ashtu, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton t’i ketë bashkëlidhur deklaratës *vetting* dokumentacion provues në lidhje me depozitimin e deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.10.2016, apo të ndonjë kërkesë tjetër drejtuar këtij institucioni për ndryshimin e vetëdeklarimit nr. {\*\*\*}, datë 17.08.2006, ashtu si pretenduar prej tij.

19.3. Sa më lart, bazuar në Udhëzimin e ILDKPKI-së nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, në pikën 9, ku përcaktohet se deklarimi i pasurive të paluajtshme në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t duhet të shoqërohet me kopje të të gjithë dokumentacionit të paraqitur pranë këtij institucioni, lidhur me deklarimin e pasurive në proces legalizimi, trupi gjykues konstaton se kopja e dokumentacionit të ALUIZNI-t, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, nuk shoqërohet me dokumentacionin sipas të cilit subjekti i rivlerësimit apo vëllezërit e tij të kenë kërkuar pranë

---

*Vërtetim hipotekor për pasurinë “truall” 460 m<sup>2</sup> dhe harta treguese e regjistrimit; - Procesverbal konstatimi i mbajtur në datën 09.09.2014,<sup>8</sup> nga Drejtoria e ALUIZNI-t 1, Qarku Tiranë; - Akt kualifikimi dhe genplan i parcelës ndërtimore dhe i sipërfaqes së ndërtimit; - Ortofoto digjitale 14.04.2007; - Planimetritë e kateve të ndërtesës; - Procesverbal i vlerësimit të dosjes së legalizimit; Kontrata e blerjes së truallit ku është ndërtuar objekti, datë 16.06.1998, sip. 460 m<sup>2</sup>; - Planvendosje e pronës; - Relacion tekniko-ligjor për kualifikim objektësh për legalizim, datë 17.08.2008 dhe fotografi të objektit; - Shkresa nr. {\*\*\*} prot, datë 29.08.2017, e ALUIZNI-t, drejtuar ILDKPKI-së; - Shkresë e ALUIZNI-t nr. {\*\*\*} prot., datë 24.08.2017, drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana Jug, për dijani ILDKPKI-së; - Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 11.07.2017, e ILDKPKI-së, drejtuar ALUIZNI-t; - Formular aplikimi nr. {\*\*\*} prot., datë 09.04.2019, sipas të cilit rezulton se vëllai i subjektit të rivlerësimit, B. B., ka aplikuar nëpërmjet këtij formulari për depozitimin e certifikatës së pronësisë mbi truallin, e cila rezulton të jetë lëshuar më datë 07.02.2019.*

ALUIZNI-t ndryshimin e formularit të vetëdeklarimit për legalizimin e objektit nr. {\*\*\*}. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, nëse subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e bashkëinvestimit edhe me vëllain tjetër, A. B., për të cilin pretendon se ka kryer procedurat për ta përfshirë në procesin e legalizimit, duke i njohur atij të drejta mbi objektin e ndërtuar, do të duhej të kishte shoqëruar deklaratimet e tij me kopje të dokumentacionit të paraqitur në kohën e plotësimit të formularit për vetëdeklarim pranë ALUIZNI-t, si dhe gjithë dokumentacionin ndryshues, i cili duhet të ishte bërë pjesë e dosjes së legalizimit. Vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. A. B., nuk rezulton të jetë deklaruar si bashkëinvestues në vitin 2006, në kohën e aplikimit për legalizim të objektit të ndërtuar dhe as gjatë kohëzgjatjes së periudhës së legalizimit në mënyrën e pretenduar prej subjektit të rivlerësimit.

19.4. Një fakt i tillë është deklaruar për herë të parë në deklaratën *vetting* dhe, për të provuar këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.10.2016, “Për njohje shpenzimesh financiare”, duke pretenduar se nëpërmjet kësaj deklarate provohet kontributi financiar, si dhe rregullohen raportet e bashkëpronësisë, ku sipas tij është kërkuar edhe përfshirja e vëllait tjetër të tij si posedues i 1/3 pjesë takuese të kësaj pasurie. Sakaq, referuar përmbajtjes së kësaj deklarate noteriale,<sup>9</sup> trupi gjykues konstaton se deklarues janë vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, por jo ky i fundit. Ky deklaram ka të bëjë me njohjen e shpenzimeve financiare, megjithatë, nuk rezulton t’i jetë drejtuar ndonjë institucioni konkret, për sa kohë deklaruesit shprehen vetëm se: “*E bëjnë këtë deklaratë noteriale për efekte ligjore e morale dhe për të theksuar faktin e shpenzimeve financiare për ndërtimin e godinës së banimit*”. Po ashtu, nuk rezulton që kjo deklaratë noteriale të ketë lënë gjurmë të depozitimit pranë ndonjë institucioni, në vitin 2016, apo të jetë shoqëruar me kërkesë për depozitim të saj pranë ALUIZNI-t, nëpërmjet së cilës të jetë kërkuar ndryshimi i vetëdeklarimit të kryer në vitin 2006, në lidhje me emrat e bashkëinvestitorëve dhe përcaktimin e pjesëve takuese, si dhe përfshirjen e vëllait tjetër të subjektit si bashkëpronar.

19.5. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se mosdeklarimi i vëllait A. B., në formularin e legalizimit, në vitin 2006, ka ndodhur për faktin se në kohën e plotësimit të formularit nuk ndodhej në Tiranë, trupi gjykues e çmoi jo bindës këtë argument, për sa kohë ai bie ndesh me dokumentacion e dorëzuar prej tij në zyrën e ALUIZNI-t, në vitin 2006, si dhe me deklaramin për herë të parë para fillimit të detyrës, në vitin 2013, ku bashkëpronësia dhe bashkëinvestimi është deklaruar në ½ pjesë takuese të subjektit me vëllain, B. B. Vetëdeklarimi pranë ALUIZNI-t, në vitin 2006, dhe deklarami për herë të parë pranë ILDKPKI-së, në vitin 2013, japin të njëjtin informacion origjinal në drejtim të fakteve të kohës, ku në asnjë rast nuk përmendet emri i vëllait A. B. Për më tepër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarame kontradiktore në lidhje me arsyen e mospërfshirjes së vëllait në procedurën e legalizimit pranë ALUIZNI-t, ku fillimisht ka deklaruar se vëllai i tij, A. B., nuk është përfshirë në procedurë, pasi ai ndodhej jashtë Tiranës, më tej pretendon se përfshirja e tij ishte e

---

<sup>9</sup> Deklaruesit A. B. dhe B. B. deklarojnë se: “... kanë investuar vlera financiare për ndërtimin e një godine 3-katëshe, të ngritur mbi truallin me sip. 145 m<sup>2</sup>. Trualli është i regjistruar në emër të shtetasve Bajram dhe B. B. Sipas deklaramesve, vlera e investuar në objekt është rreth 8.000.000 lekë, ku shtetasi Bajram Breçani ka investuar shumat 3.000.000 lekë për ndërtimin e objektit dhe 2.000.000 lekë për punime të brendshme. Kontributi i tij financiar përfshin periudhën 1996 – 2003. Deklaruesi A. B. ka investuar 2.000.000 lekë, kurse shtetasi Bajram Breçani ka investuar 3.000.000 lekë. Burimi i të ardhurave për shtetasin A. B. është nga veprimtaria private në tregtim artikuj të ndryshëm, ndërsa e shtetasit B. B. është nga emigracioni në Itali dhe, më pas, nga puna si rezident në ShBA. Deklaruesit pohojnë se deklarata noteriale është bërë për arsye ligjore dhe morale, dhe për të theksuar faktin e shpenzimeve financiare për ndërtimin e godinës së banimit”.

pamundur, pasi toka ishte në pronësi të tij dhe të vëllait tjetër, ndërsa vetë z. A. B., në memon drejtuar Komisionit, më datë 18.07.2022, ka deklaruar se aplikimi është kryer vetëm prej shtetasve Bajram e B. B., për arsye se, për t'u shtuar si pronar, nevojitej një pagesë shtesë, për shkak se trualli ishte në pronësi të të dy vëllezërve të tij, shumë të cilën ai nuk e dispononte në momentin e aplikimit.

19.6. Trupi gjykues e gjen të pambështetur edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se deklarimi për herë të parë, para fillimit të detyrës në vitin 2013, është një pasaktësi nga ana e tij, për sa kohë ky deklarim përputhet me të dhënat e formularit të vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t, si dhe të gjithë dokumentacionin shoqërues në lidhje me gjendjen e bashkëpronësisë dhe posedimin e ndërtimit. Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se aplikimi i parë për legalizimin e objektit të ndërtuar është realizuar në vitin 2006, nëpërmjet dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit nr. {\*\*\*} prot., datë 17.08.2006, dhe për një periudhë 10-vjeçare, kohë gjatë së cilës procedura e legalizimit ishte ende në proces dhe nga ana e subjektit të rivlerësimit apo e vëllezërve të tij nuk është ndërmarrë asnjë veprim për ndryshimin e vetëdeklarimit në lidhje me bashkinvestuesit. Një fakt i tillë fillon të shfaqet pak kohë para fillimit të procesit të rivlerësimit dhe pasi ishte miratuar ligji nr. 84/2016,<sup>10</sup> që në vlerësimin e trupit gjykues konsiderohen si veprime të vonuara dhe të pamjaftueshme për arritjen e qëllimit të pretenduar, për sa rezultoi e provuar se leja e legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 17.09.2020, është miratuar bazuar në dokumentacionin dhe të dhënat e dosjes së legalizimit në emër të Bajram e B. B., sipas së cilës është vijuar me regjistrimin e pasurisë pranë ASHK-së në pronësi të tyre, secili me ½ pjesë takuese.

19.7. Në vijim të kësaj analize, trupi gjykues vëren gjithashtu se, megjithëse certifikata e pronësisë mbi pasurinë objekt shqyrtimi ka dalë më datë 22.09.2020, përsëri nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit apo ndonjë prej vëllezërve të tij të ketë filluar me iniciativë të përbashkët apo personale ndonjë procedurë për rregullimin e bashkëpronësisë në mënyrën e pretenduar gjatë hetimit administrativ në Komision. Fillesat e këtij veprimi rezultojnë vetëm në vitin 2022, pas njoftimit të rezultateve të hetimit më datë 12.07.2022, ku bashkëlidhur prapësimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar komunikimin shkresor nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2022 me ASHK-në, Drejtoria Vendore Tirana Jug, si dhe përgjigjen e kësaj të fundit në të njëjtën datë, ku pranohet fakti i dorëzimit të deklaratës noteriale pranë drejtorisë së ALUIZNI-t, në vitin 2016, si dhe fakti i posedimit të objektit nga të tre vëllezërit.

19.8. Në lidhje me praktikën shkresore nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2022, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug, trupi gjykues vëren se, edhe pse Komisioni është njohur me këtë praktikë shkresore, si edhe me pretendimet e subjektit të rivlerësimit rreth rëndësisë dhe vlerës provuese të përgjigjes së ASHK-së, nuk rezulton të jetë shprehur në vendim në mënyrë të posaçme në lidhje me këtë komunikim shkresor, por, në paragrafin 1.31 të vendimit, Komisioni është shprehur se: *Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokumentacion provues dhe nuk rezultoi që të ishte ndërmarrë ndonjë veprim ligjor për përfshirjen e vëllait, A. B., në procesin e legalizimit dhe regjistrimit më pas të kësaj pasurie pranë ASHK. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim sipas pretendimit të tij për ndarjen e pasurisë në emër të tre bashkëpronarëve që nga momenti i krijimit të pasurisë dhe as që nga deklarata vetting deri më sot.* Bazuar në këtë konkluzion, kuptohet se Komisioni ka vlerësuar të mos marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e paraqitura prej tij, pasi është njohur me rezultatet e hetimit,

<sup>10</sup> Miratuar në datën 30.08.2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.09.2016.

të cilat i ka konsideruar të pamjaftueshme për të përmbysur barrën e provës, duke e bazuar vendimmarrjen e tij në dokumentacionin e administruar deri në atë moment nga Komisioni sa i takon dosjes së legalizimit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk ka shqyrtuar faktet e provat e paraqitura prej tij, është i pambështetur.

**19.9.** Sa i takon pretendimeve të subjektit, se në aktin e konstatimit në terren, të realizuar nga punonjësit e ASHK-së, figurojnë të tre emrat e bashkëpronarëve, trupi gjykues konstaton se, referuar shkresës së ASHK-së nr. {\*\*\*} prot., datë 22.07.2020, drejtuar Komisionit, në dokumentacionin bashkëlidhur, ASHK-ja ka përcjellë dokumentin “Procesverbal konstatimi i mbajtur në datën 09.09.2014”, mbajtur nga Drejtoria e ALUIZNI-t, Tiranë, sipas të cilit konstatohet se sipërfaqja e parcelës së ndërtimit është 500 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e bazës së objektit 148.6 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 555.3 m<sup>2</sup>, banesë me tre kate, ka si deklarues e palë blerëse B. dhe Bajram Breçani dhe në asnjë moment nëpër këto shkresa, pjesë e dosjes së legalizimit, nuk rezulton të jetë referuar shtetasi A. B. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë kontributin e vëllait, A. B., në ndërtimin e objektit dhe, për pasojë, se ai zotëron 1/3 pjesë takuese të pasurisë objekt shqyrtimi.

**19.10.** Në përpjekje për të provuar deklaratimet e tij në deklaratën *vetting*, pas përfundimit të procesit të rivlerësimit në Komision, subjekti i ka bashkëlidhur ankimit edhe urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 21.10.2022, të Drejtorit të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug, nëpërmjet të cilit rezulton të jetë bërë korigjimi i lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 17.09.2020, dhe certifikatës së pronësisë, lëshuar në datën 22.09.2020, mbi bazën e kërkesës së vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. A. B. Referuar këtij urdhri, trupi gjykues konstaton se Drejtori i Drejtorisë ka bërë korigjimin e lejes së legalizimit dhe certifikatës së pronësisë, së lëshuar për Bajram e B. B. Baza ligjore e këtij urdhri referon aplikimin e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”, ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare”, pikës 3 të VKM-së nr. 954<sup>11</sup>, datë 25.11.2015, “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të lejes së legalizimit”, nenit 16 të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., 28.10.2016, deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.10.2022,<sup>12</sup> deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.10.2022 dhe konstatimin në terren, datë 27.08.2020. Nëpërmjet këtij akti, Drejtori i Drejtorisë Vendore Tirana Jug ka korigjuar gabimet në të dhënat kadastrale,<sup>13</sup> duke pranuar se për lejen e legalizimit nr. {\*\*\*}, datë

<sup>11</sup> *Vendim i shfuqizuar me vendimin nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.*

<sup>12</sup> *Deklarata noteriale nga shtetasi Bajram, H., B. dhe R. B.*

<sup>13</sup> *Neni 13 i ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, parashikon se: “Çdo pasuri e paluajtshme regjistrohet në Kadastrë, duke u pasqyruar në kartelën përkatëse të pasurisë dhe në hartën kadastrale. 2. Kartelat dhe hartat që përbëjnë Kadastrën administrohen në format shkresor dhe digjital. 3. Kartela e pasurisë mban detyrimisht të dhëna për: a) pozicionin gjeografik të pasurisë; b) sipërfaqen e pasurisë; c) llojin e pasurisë së paluajtshme (ndërtesë, truall, arë, kullotë etj.); ç) identifikimin e pronarit të pasurisë; d) aktin nga i cili ka lindur titulli i pronësisë mbi pasurinë; dh) të drejtat e të tretëve mbi pasurinë dhe aktet prej të cilave ato burojnë; e) vlerën e pasurisë; ë) çdo akt tjetër që ndryshon regjimin juridik të pronës apo krijon të drejta, apo detyrime mbi pasurinë; f) të dhëna të tjera që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 4. Dokumentacioni për të drejtat dhe të dhënat e tjera mbi pasurinë, mbi bazën e të cilit plotësohet kartela, ruhet dhe arkivohet në Drejtorinë Vendore. 5. Modeli i kartelës së pasurisë së paluajtshme përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. 6. Kadastra në format digjital përbën bazën shtetërore të të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme. Ministria e Drejtësisë ka akses*

17.09.2020, nuk është marrë në konsideratë deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.10.2016, ku A., B. dhe Bajram Breçani kanë deklaruar se kanë investuar së bashku në truallin në emër të Bajram e B. B., fakt i konfirmuar nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.10.2022, si dhe sipas konstatimit në terren, më datë 27.08.2020, ku ka rezultuar se ky objekt posedohej nga Bajram Breçani, B. B. dhe A. B. Në vijim të arsyetimit të këtij akti, Drejtori i Drejtorisë shprehet se, ndodhur në kushtet kur deklarata e mësipërme noteriale, hartuar dhe depozituar para emetimit të lejes së legalizimit, nuk është marrë në konsideratë, leja e legalizimit është në kundërshtim me pikën 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 954, datë 25.11.2015, i cili përcakton se leja miratohet për subjektin përfutës, që sipas rastit është aplikuesi për legalizim ose/dhe personi të cilit i janë njohur të drejta mbi ndërtimin pa leje.

**19.11.** Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se aktet e bashkëlidhura nga subjekti i rivlerësimit i referohen fakteve që kanë ndodhur pas dhënies së vendimit nga ana e Komisionit dhe përmbajtja e tyre nuk provon bashkinvestimin nga ana e vëllait A. B., në mënyrën e pretenduar nga subjekti. Këto akte çmohen pa vlerë provuese për situatën faktike në kohën kur është krijuar pasuria objekt kontrolli. Fakti që subjekti dhe vëllai i tij, B. B., në vitin 2022, kanë vepruar për ndarjen e pasurisë, duke i kaluar në pronësi vëllait tjetër, A. B., 1/3 e pasurisë, apo se leja e legalizimit është korigjuar me anë të një akti administrativ, sipas kërkesës së njërit prej vëllezërve, në vitin 2022, në vlerësimin e trupit gjykues nuk arrin të provojë bashkinvestimin për ndërtimin e objektit në mënyrën e pretenduar nga subjekti.

**19.12.** Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit, sa i takon kohës dhe kostos së ndërtimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlera e investuar prej tij në ndërtimin e objektit të banimit është në shumën prej 3.000.000 lekësh, për ngritjen e objektit dhe 1.200.000 lekësh, për përfundimin e pjesës së brendshme takuese dhe mobilimin, dhe se vlera totale e investuar prej tij në këtë objekt është 5.000.000 lekë, e shtrirë deri në vitin 2005, trupi gjykues vëren se:

- Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar fillimin e punimeve në fund të vitit 1996, fillim viti 1997, megjithatë nuk rezulton të ketë deklaruar datën e përfundimit të tyre. Vlera e shpenzuar në total për këtë banesë deklarohet të jetë 8.000.000 lekë, nga të cilat 3.000.000 lekë deklarohen të shpenzuara nga subjekti i rivlerësimit për ndërtimin e pjesës së tij takuese, ndërsa për rregullim dhe arredim deklarohet të jenë shpenzuar rreth 2.500.000 lekë.
- Në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2013, subjekti rezulton të ketë deklaruar ndërtimin e banesës në vitin 1996, me vlerë 8.000.000 lekë, ndërsa referuar formularit të vetëdeklarimit nr. {\*\*\*} prot., viti 2006, pranë ALIUZNI-t, data e ndërtimit të objektit deklarohet 05.10.1998.
- Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se: “...Gjithë arredimi së bashku me punimet e brendshme kanë kushtuar rreth 2.500.000 lekë, ku pjesën dërmuese të këtyre shpenzimeve e kanë zënë punimet e brendshme, sa i përket mobilimit dhe pajisjeve elektrike, këto janë blerë kur kemi hyrë në shtëpi, në vitin 1998, dhe nuk disponojmë fatura për çmimin e tyre”.

---

*në këtë bazë të dhënash, në rolin e mbikëqyrësit të saj. Rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për bazat e të dhënave shtetërore.*

- Në pyetëSORIN nr. 2, i pyetur në lidhje me shpenzimet e kryera prej tij për këtë pasuri, si dhe periudhat përkatëse të ndara sipas viteve, subjekti ka deklaruar se shpenzimet e ndara ndër vite janë: *Në vitin 1996, rreth 1.100.000 lekë; në vitin 1997, rreth 2.500.000 lekë; në vitin 1998, rreth 600.000 lekë; në vitin 2005, rreth 1.000.000 lekë, pjesa tjetër janë investime të vogla ndër vite, ku përfshihet edhe mobilimi i shtëpisë.*

- Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka deklaruar shpenzimet për ndërtimin e pjesës takuese të ndara si më poshtë: *Në vitin 1996, rreth 1.100.000 lekë; në vitin 1997, rreth 2.000.000 lekë; në vitin 1998, rreth 600.000 lekë; në vitin 2005, rreth 1.000.000 lekë.*

**19.13.** Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues vëren dhe vlerëson se ekzistojnë disa mospërputhje në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, sa i takon kohës dhe kostos së ndërtimit, si dhe shpenzimeve për arredim dhe mobilim. Në deklaratën *vetting*, shpenzimet për ndërtimin e pjesës së tij takuese deklarohen në vlerën 3.000.000 lekë dhe 2.500.000 lekë për rregullim dhe arredim, duke e çuar vlerën totale të shpenzuar prej tij në shumën 5.500.000 lekë, pa përcaktuar kohën e kryerjes së këtyre shpenzimeve. Ndërkohë që, kur është pyetur nga Komisioni në lidhje me shpenzimet e ndara sipas viteve, në përgjigje të pyetëSORIT nr. 2, subjekti, për periudhën 1996 – 1998 (koha e ndërtimit<sup>14</sup>), deklaron të shpenzuar shumën 4.200.000 lekë dhe në vitin 2005 deklarohen të shpenzuara rreth 1.000.000 lekë, duke e çuar vlerën totale të shpenzuar prej tij në 5.200.000 lekë. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore në Komision, shpenzimet për vitin 1997 deklarohen të jenë kryer në vlerën 2.000.000 lekë, duke bërë që e gjithë shuma për ndërtimin të rezultojë në masën 3.700.000 lekë dhe në masën 4.700.000 lekë si vlerë totale e investimit, ndërsa në ankim, subjekti ka ngritur pretendimin se vlera e investuar prej tij për ndërtimin e objektit të banimit është në shumën prej 3.000.000 lekësh për ngritjen e objektit dhe 1.200.000 lekë për përfundimin e pjesës së tij takuese të brendshme dhe mobilimin, dhe vlera totale e investuar prej tij në këtë objekt është 5.000.000 lekë, e shtrirë deri në vitin 2005.

**19.14.** Trupi gjykues konstaton gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor mbështetës për investimet dhe shpenzimet e kryera për ndërtimin e godinës, të tilla si situacione punimesh, fatura për shpenzimet e rregullimit të brendshëm dhe arredim/mobilimit të saj. I vetmi akt i paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim, është akti i ekspertimit teknik, i hartuar prej vlerësueses së pasurive të paluajtshme, të përzgjedhur prej tij për nevoja të procesit të rivlerësimit. Në lidhje me këtë akt ekspertimi, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se vlera provuese e tij është e kufizuar, pasi, përtej faktit se mund të jetë hartuar nga një ekspert i licencuar, ai rezulton të jetë përgatitur në përgjigje të kërkesave, sugjerimeve apo fakteve të servitura prej subjektit dhe të pakonfirmuara nga ndonjë autoritet publik. Për këtë arsye, në mungesë të çdo akti tjetër, që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi, përllogaritja e shpenzimeve për ndërtimin mbi bazën e kostos sipas çmimeve të EKB-së mbetet një standard i arsyeshëm<sup>15</sup>.

**19.15.** Pavarësisht sa më lart, trupi gjykues konstaton se, megjithëse në rezultatet e hetimit, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit duke përllogaritur vlerën e ndërtimit sipas standardit të EKB-së, në analizën përfundimtare rezultojnë të ketë përllogaritur

<sup>14</sup> Për vitin 1997 deklarohet shpenzim në shumën 2.500.000 lekë.

<sup>15</sup> Vendimet e Kolegjit nr. 6/2022 (JR), datë 17.03.2022, që i përket subjektit H. K., paragrafin 14.5 dhe nr. 35/2022 (JR), datë 22.09.2022, që i përket subjektit E. Sh.

vlerën e investimit në lidhje me këtë pasuri në masën 50% të vlerës së deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2013, si dhe në deklaratën *vetting*, në shumën 4.000.000 lekë, që në fakt rezulton më e ulët se vlera e përlllogaritur sipas kostos së ndërtimit të përlllogaritur mbi referencat e kostove sipas EKB-së. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së ndërtimit janë të pambështetura.

**19.16.** Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit sa i takon shpenzimeve për arredimin, mobilimin dhe përshtatjen e banesës, trupi gjykues konstaton se në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për rregullim dhe arredim të brendshëm ka shpenzuar rreth 2.500.000 lekë, pa përcaktuar kohën në të cilën mund të jenë kryer këto shpenzime. Në pyetësorin standard, subjekti po ashtu ka deklaruar se arredimi dhe punimet e brendshme kanë kushtuar 2.500.000 lekë, ku pjesën dërrmuese e zënë punimet e brendshme, ndërsa mobilimi dhe pajisjet janë blerë kur kanë hyrë në shtëpi, në vitin 1998. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Punimet e rikonstruksionit të kryera në vitin 2005, të cilat konsistojnë në shtrim veshje tualet, kat përdhe, vendosje grilash veneciane në vetrata e dritare duralumin, shtrim oborri me pllaka e sistemim (në masën 1/3), suvatim në fasadën e jashtme te veranda e katit përdhe, vendosje e parmakëve alumin në ballkone e verandë. Vlera e këtyre punimeve kap shumën totale 978.489 lekë”*.

**19.17.** Referuar rezultateve të hetimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni shpenzimet e arredimit, mobilimit dhe përshtatjes i ka konsideruar aq sa deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, në shumën prej 2.500.000 lekësh, ndërsa periudha e investimit/blerjes së tyre është marrë në konsideratë sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në pyetësorin standard<sup>16</sup>. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore, sa i takon shpenzimeve për arredim dhe punime të brendshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“... Këto shpenzime kanë ndodhur në periudha të mëvonshme dhe jo në periudhën e përfshirë në analizën financiare të hartuar nga ana juaj. Po të shohësh, edhe logjikisht, është e pamundur për një familje shqiptare që në periudhën 1997 – 1998 të shpenzonte 2.500.000 lekë të reja për arredimin e shtëpisë, pasi, edhe po t’i kishte këto para, do ta kishte të pamundur t’i shpenzonte për arredim. Edhe sot e kësaj dite, me gjithë shpenzimet e bëra ndër vite, shpenzimet e arredimit në shtëpinë time nuk e kalojnë vlerën 1.500.000 lekë të reja dhe ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm dhe, nëse nuk jeni të bindur, në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, mund të bëni këqyrje në vend, të gjendjes së mobilimit të shtëpisë, si dhe gjendjen faktike të katit të tretë të banimit. Sa i përket punimeve të brendshme, ato janë bërë në vitin 2005 dhe kjo provohet nga kontrata e kredisë me PSHM, në datën 26.04.2005, në seksionin e aplikimit për kredi deklarohet se kjo kredi ka për qëllim arredimin në shtëpinë time, kontratë të cilën e keni administruar në dosjen e rivlerësimit. I gjithë investimi i familjes time për rregullime të brendshme, pajisje elektrike dhe hidraulike dhe mobilim e arredim, ka vlerën totale 2.500.000 lekë, pa kufizim në kohë, sipas deklarimeve të bëra më parë, në momentin e hyrjes në shtëpinë e banimit kam kryer blerje vetëm për pajisje hidraulike dhe elektrike”*. Në konkluzionin përfundimtar të Komisionit në vendim, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka ndryshuar qëndrim sa i takon vlerës së shpenzimeve për punimet e brendshme, arredim dhe përshtatje, të cilat i ka përfshirë në analizën

<sup>16</sup> Përgjigjja nr. 14: *“Siç kam deklaruar në deklaratën *vetting* dhe ILDKPKI, gjithë arredimi së bashku me punimet e brendshme ka kushtuar rreth 2.500.000 lekë, ku pjesë dërrmuese të këtyre shpenzimeve e kanë zënë punimet e brendshme, sa i përket mobilimit dhe pajisjeve elektrike, këto janë blerë kur kemi hyrë në shtëpi, në vitin 1998, dhe nuk disponojmë fatura për çmimin e tyre”*.

financiare në shumën 1.200.000 lekë, në vitin 1998, me arsyetimin se i është referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin nr. 2<sup>17</sup>, ndërsa vetë subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se shpenzimet në shumën 1.200.000 lekë janë përfshirë padrejtësisht nga Komisioni si shpenzime deri në vitin 1998, me argumentin se një fakt i tillë nuk është deklaruar asnjëherë prej tij, sikurse arsyeton Komisioni.

**19.18.** Në vlerësim të sa më sipër, referuar akteve në fashikull, si dhe përfundimit të Komisionit në vendim, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, edhe pse është pyetur disa herë nga Komisioni, në përgjigjet e dhëna nuk ka detajuar në mënyrë të qartë shpenzimet e kryera prej tij për punimet e brendshme, mobilim dhe arredim, dhe se shuma totale e deklaruar prej tij është 2.500.000 lekë. Po ashtu, nuk rezulton që ai të ketë dorëzuar dokumentacion justifikues, me qëllim për të saktësuar vlerën dhe kohën e kryerjes së tyre, me përjashtim të shpenzimeve të kryera në vitin 2005, për të cilat rezulton se ka kryer shpenzime rikonstruksioni me vlerë 978.498 lekë.

**19.19.** Sa më sipër, referuar përgjigjeve të pyetësonit standard, ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjithë arredimi së bashku me punimet e brendshme ka kushtuar 2.500.000 lekë, ku pjesën dërrmuese e kanë zënë punimet e brendshme dhe se mobilimi dhe pajisjet elektrike janë blerë në vitin 1998 (pa fatura), përftohet informacioni se mobilimi është kryer gjatë vitit 1998, kur familja ka filluar të banojë në këtë banesë. Megjithëse subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë përcaktuar vlerën e shpenzuar për mobilim dhe pajisje në vitin 1998, si dhe në mungesë të faturave përkatëse, pjesa më e madhe e shpenzimeve të kësaj natyre duhet të përlllogaritet si e kryer në fillimet e banimit dhe, mbi këtë arsyetim, përlllogaritja e tyre në vitin 1998 duket e drejtë dhe logjike.

**19.20.** Nga kontrolli i analizës financiare, rezulton se Komisioni, në vitin 1998, ka përfshirë vlerën 1.200.000 lekë si shpenzim për arredim dhe punime të brendshme, duke arsyetuar se është bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting*, lidhur me kredinë në vlerën 12.000 euro, pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, si dhe në përgjigjet e tij në pyetësonin nr. 2. Referuar arsyetimit të Komisionit, në pikën 1.41 të vendimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk shpjegon formulën e ndjekur për përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve me vlerë 1.200.000 lekë.<sup>18</sup> Megjithatë, referuar akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se, ndryshe nga sa ka pretenduar në vazhdim, në pyetësonin nr. 1, subjekti ka deklaruar se mobiliet dhe pajisjet elektroshtëpiake janë blerë në vitin 1998, ndërsa në pyetësonin nr. 2, subjekti ka deklaruar shpenzime për periudhën 1996 – 1998, në vlerën 4.200.000 lekë, nga të cilat, kostoja e ndërtimit e pretenduar nga subjekti është 3.000.000 lekë dhe diferenca prej 1.200.000 lekësh ndërmjet këtyre vlerave duket se i përket shpenzimeve për mobilim dhe punime të brendshme. Për sa më lart, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit lidhur me faktin se shpenzimet e arredimit, deri në vitin 1998, kanë qenë në vlerën prej 1.200.000 lekësh.

**19.21.** Lidhur me pretendimin e subjektit, se nga ana e Komisionit nuk është marrë parasysh akti i ekspertimit i kryer nga ekspertja e përzgjedhur prej tij, e cila ka dhënë mendimin e saj shkencor, bazuar në një sërë provash, pjesë e fashikullit, dhe se Komisioni ka kryer përlllogaritje

---

<sup>17</sup> Përgjigjja nr. 2, pyetësoni nr. 2: “Shpenzimet e ndara ndër vite janë si më poshtë: në vitin 1996, rreth 1.100.000 lekë; në vitin 1997, rreth 2.500.000 lekë; në vitin 1998, rreth 600.000 lekë dhe në vitin 2005, rreth 1.000.000 lekë [...] punimet e rikonstruksionit të kryera në vitin 2005, vlera totale 978.498 lekë”.

<sup>18</sup> Një shifër e tillë nuk pasqyrohet në tabelën e analizës financiare të Komisionit për periudhën gusht 1995 – maj 2000.

të gabuar të vlerës së investimit, duke e ndarë atë në  $\frac{1}{2}$  pjesë takuese dhe jo në  $\frac{1}{3}$ , sipas deklaratimit të tij në deklaratën *vetting*, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson se, megjithëse Komisioni fillimisht ka llogaritur vlerën e ndërtimit të pjesës takuese të subjektit ( $\frac{1}{2}$ ) bazuar në kostot mesatare sipas udhëzimeve të EKB-së, për vitet 1996 – 1998 (4.921.492 lekë), në konkluzionet përfundimtare në vendim ka mbajtur një qëndrim garantues ndaj subjektit, duke pranuar vlerën totale të ndërtimit në shumën prej 8.000.000 lekësh, të deklaruar prej tij në deklaratën e vitit 2013, si dhe në deklaratën *vetting*, duke përlllogaritur pjesë takuese për subjektin e rivlerësimit në masën  $\frac{1}{2}$  (4.000.000 lekë), kosto, e cila rezulton më e ulët se ajo e përlllogaritur nga Komisioni në rezultatet e hetimit. Në këto kushte, vlerësimi i ekspertës dhe akti i ekspertimit, në lidhje përlllogaritjen e koston së ndërtimit, rezultojnë jorelevantë për përcaktimin e vlerës së investuar nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë përlllogaritja e vlerës së ndërtimit të banesës nga ana e Komisionit është bërë në përputhje me deklaratimet e vetë subjektit dhe pretendimet e tij në lidhje me metodologjinë e përlllogaritjes së vlerës së investimit/koston për ndërtim, vlerësohen të pabazuara.

**19.22.** Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, sipas të cilave, subjekti pretendoi se analiza financiare e kryer nga ana e Komisionit duhet të rishikohet për sa i përket të ardhurave nga fondacioni “{\*\*\*}”, pasi ka mospërputhje për shumën e njohur nga Komisioni, sipas pikës 1.39 të vendimit, dhe asaj të pasqyruar në tabelën e analizës financiare, dhe se nga ana e Komisionit nuk janë përfshirë të gjithë mandatpagesat e paraqitura prej tij nga ky fondacion,<sup>19</sup> vlera e të cilave arrin shumën 1.897.000 lekë dhe jo aq sa Komisioni ka pasqyruar në analizën financiare. Subjekti në vijim pretendoi se, ndryshe nga sa është shprehur Komisioni në vendim, sipas një përlllogaritjeje të thjeshtë matematikore të të ardhurave nga pagat gjatë viteve 1995 – 1997, rezulton se ai ka pasur mundësi për kursime, të cilat, sipas tabelës së pasqyruar prej tij në ankim, arrijnë shifrën + 1.544.267 lekë.

**19.23.** Në analizë të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit pretendon vlera të ndryshme sa i takon të ardhurave të përfituara nga fondacioni “{\*\*\*}”, si dhe ka bërë deklaratime të ndryshme sa i takon vlerës së përdorur prej tij si burim për pasurinë objekt shqyrtimi. Kështu, referuar akteve në fashikull rezulton se në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar burimet<sup>20</sup> për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi, ndër të cilat shumën 500.000

---

<sup>19</sup> SR-ja i referohet mandatpagesave: nr. {\*\*\*}, datë 14.10.1996, nr. {\*\*\*}, datë 03.12.1996, nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, nr. {\*\*\*}, datë 20.03.1996, nr. s'ka, datë 22.11.1995, nr. {\*\*\*}, datë 03.07.1995, nr. {\*\*\*}, datë 30.08.1995 dhe nr. {\*\*\*}, datë 03.12.1996.

<sup>20</sup> Burimi i të ardhurave për ndërtimin e pjesës takuese të banesës janë: Shitja e banesës me kontratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 16.01.1997, në vlerën 2.000.000 lekë (banesë e cila ka qenë në bashkëpronësi me vëllain tim, B. U. B., me pjesë takuese 50% me 50%, që do të thotë 1.000.000 lekë të reja secili prej nesh, është blerë prej meje dhe vëllait B. U. B., në shumën 1.650.000 lekë, me kontratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 29.01.1996, me pjesë takuese 50% me 50%, e konvertuar në 825.000 lekë, nga të cilat, shuma prej 675.200 lekësh është e siguruar nga të ardhurat e fondacionit “{\*\*\*}”, sipas mandatpagesave (në datat 22.11.1995, 03.07.1995, 30.08.1995), duke respektuar normat ligjore, të njohura nga shteti shqiptar, mbi bazën e të cilave funksiononte ky fondacion [...]. Gjithashtu, burim i krijimit të të ardhurave për ndërtimin e pjesës takuese në banesën private me sip. prej 145 m<sup>2</sup>, truallit dhe murit rrethues të banesës është aktmarrëveshja nr. {\*\*\*} i regj., datë 12.03.1997, që përcakton shitjen e banesës shtetasit A. Ll. C., në Lushnjë, lagjia “{\*\*\*}”, kontratë noteriale shitjeje nr. {\*\*\*}, datë 06.09.2001. E ardhur tjetër e shfrytëzuar për ndërtimin e banesës dhe murit rrethues është edhe shuma prej 500.000 lekësh, që vjen nga mandatpagesa nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, nga fondacioni “{\*\*\*}”, i njohur nga ligji shqiptar i asaj kohe, veprimet kontraktuese nga ana ime me këtë fondacion janë kryer sipas ligjit dhe statutit që mbante ky fondacion. Sqarohet se i kam marrë vëllait tim, B. U. B., huan në shumën 600.000 lekë, të cilën e

lekë, të ardhura nga fondacioni “{\*\*\*}”. Në deklaratën e vitit 2013, nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri, ndërkohë që në pyetësin nr. 2, i pyetur nga Komisioni në lidhje me shpenzimet e kryera prej tij, për pasurinë objekt shqyrtimi, si dhe periudhat përkatëse, subjekti ka deklaruar: “...Rreth 1.100.000 lekë nga paratë e investuara në fondacionin ‘{\*\*\*}’”. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur subjekti i rivlerësimit edhe në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, ku pretendon se të ardhurat nga ky fondacion janë rreth 1.100.000 lekë, ndërkohë që, referuar tabelës së analizës financiare, faqja 12 e prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit, të njëjtat të ardhura pretendon t’i përlllogariten në shumën 1.687.200 lekë, ndërsa në ankim pretendon se vlera sipas mandatpagesave nga ky fondacion është në shumën 1.897.000 lekë. Sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë konsistent në deklaratimet e tij në lidhje me të ardhurat e përfituara nga fondacioni “{\*\*\*}”.

**19.24.** Nga kontrolli i analizës financiare,<sup>21</sup> mbi mundësinë e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, rezulton se Komisioni ka përfshirë në analizë burimet e deklaruara, ndër të cilat edhe vlerën 500.000 lekë, të deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas mandatarëkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, nga fondacioni “{\*\*\*}”, ndërkohë që, referuar përmbajtjes së pikës 1.39 të vendimit, duket sikur Komisioni ka pranuar si të ardhur nga fondacioni “{\*\*\*}” edhe shumën 825.000 lekë. Sa më sipër, vlerësohet si një lapsus nga ana e Komisionit, pasi shuma prej 825.000 lekësh, në vlerësimin e trupit gjykues përfaqëson vlerën e blerjes së apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”,<sup>22</sup> Tiranë, i cili është blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij, B. B., në vlerën 1.650.000 lekë, me pjesë takuese 50% secili. Nga shitja e këtij apartamenti rezulton se subjekti ka përfitur si pjesë takuese shumën 1.000.000 lekë, nga të cilat 149.800 lekë janë përdorur për shlyerjen e borxhit ndaj B. për blerjen e këtij apartamenti dhe vlera neto e përfitur nga shitja është 850.200 lekë. Referuar tabelës së analizës financiare për periudhën (gusht 1995 – maj 2000),<sup>23</sup> trupi gjykues konstaton se Komisioni ka pranuar në analizën financiare të ardhurat nga fondacioni “{\*\*\*}” në shumën 500.000 lekë, sipas mandatpagesës nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, dhe shumën 675.200 lekë, sipas mandatpagesave të datave 22.11.1995, 03.07.1995 dhe 30.08.1995, deklaruar në deklaratën *vetting*. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht lapsusit në pikën 1.39 të vendimit, të ardhurat nga fondacioni “{\*\*\*}”, të cilat kanë shërbyer si burim për ndërtimin e banesës, janë përlllogaritur në përputhje me deklaratimet e vetë subjektit, në deklaratën *vetting*.

**19.25.** Sa i takon pretendimit të subjektit, se gjatë viteve 1995 – 1997, sipas një përlllogaritjeje të thjeshtë matematikore të të ardhurave nga pagat, rezulton se ai ka pasur mundësi për kursime, të cilat kanë shërbyer si e ardhur për krijimin e pasurisë, trupi gjykues mori në analizë deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting* sa i takon burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë “shtëpi banimi”, ku rezulton të jenë deklaruar: të ardhura nga shitja e banesës me kontratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 16.01.1997, në vlerën 2.000.000 lekë (banesë, e cila ka qenë në bashkëpronësi me vëllain tim, B. U. B., me pjesë takuese 50% me 50%, 1.000.000 lekë secili); të ardhurat sipas aktmarrëveshjes nr. {\*\*\*} i regj., datë 12.03.1997, që përcakton shitjen e banesës shtetasit A. Ll. C., në qytetin e Lushnjës, lagjja “{\*\*\*}”, me kontratë noteriale shitjeje

---

kam kthyer në vitin 2003, para të ardhura nga kursimet e mia të pagës dhe kreditë e marra nga PSHM-ja, dhe sot e quajtur NOA.

<sup>21</sup> Pika 1.38, Analiza financiare, f. 18 e vendimit të Komisionit.

<sup>22</sup> Deklaruar në deklaratën *vetting* si një prej burimeve të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, që në fakt rezulton të jetë krijuar me të ardhura nga fondacioni “{\*\*\*}”, në shumën 675.200 lekë.

<sup>23</sup> Referuar analizës financiare (gusht 1995 – maj 2000), në faqen 32 të vendimit të Komisionit.

nr. {\*\*\*}, datë 06.09.2001, shuma 1.500.000 lekë; shuma prej 500.000 lekësh, sipas mandatpagesës nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, nga fondacioni “{\*\*\*}”; hua nga vëllai i subjektit, B. B., në shumën 600.000 lekë, kthyer në vitin 2003, para të ardhura nga kursimet e pagës dhe kreditë e marra nga PSHM-ja, sot e quajtur NOA. Burimet e deklaruara janë marrë në konsideratë nga Komisioni sipas deklarimit të subjektit në deklaratën *vetting*, ndërkohë që në lidhje me pretendimin e subjektit, se burim tjetër janë edhe të kursimet ndër vite, Komisioni nuk i ka konsideruar në analizën financiare, me arsyetimin se nuk janë deklaruar si burim në deklaratën *vetting*, si dhe sepse, për vitet 1995 – 1998, subjekti rezulton në pamundësi financiare për kursim. Sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit në lidhje me moskonsiderimin e kursimeve si burim për krijimin e pasurisë, pasi, përveç mosdeklarimit, nuk provohet që subjekti i rivlerësimit gjatë kësaj periudhe kishte mundësi që, me të ardhurat nga paga, të përballonte shpenzimet e jetesës dhe kostot e ndërtimit. Sa më sipër, pretendimi i subjektit, se si burim për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi kanë shërbyer edhe kursimet, vlerësohet i pambështetur.

**19.26.** Në përfundim të kësaj analize, lidhur me pasurinë e paluajtshme “shtëpi banimi”, me sipërfaqe 150.5 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, dhe truall me sipërfaqe 671.2 m<sup>2</sup>, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj në vlerën e konkluduar prej tij, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë përfshirjen e vëllait, A. B., në financimin e kësaj pasurie dhe, për pasojë, të provojë se atij i përket 1/3 pjesë e saj. Në ndryshim nga Komisioni, trupi gjykues vlerësoi se përpjekjet e tij për të dokumentuar dhe provuar vërtetësinë e deklarimeve të tij në deklaratën *vetting*, të cilat datojnë pak para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, që në muajin tetor 2016, pasqyronin një reagim të vonuar dhe të pamjaftueshëm, për të arritur një nivel provueshmërie të kënaqshëm në raport me pretendimet e tij. Në këto kushte, trupi gjykues, ndonëse nuk përjashton krejtësisht ekzistencën e fakteve të pretenduara prej subjektit në lidhje me pjesët takuese të tij dhe të vëllezërve, nuk mundi të arrijë në një konkluzion të ndryshëm nga Komisioni lidhur me to. Në këtë kuptim, edhe për trupin gjykues rezulton se është i drejtë konkluzioni i Komisionit, se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar ½ pjesë të kësaj pasurie, deri në vitin 1998, në vlerën prej (-) 1.933.800 lekësh, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**20.** Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit për automjetin me targë {\*\*\*}, shitur më datë 01.03.2009, në shumën 430.000 lekë, automjetin {\*\*\*}, shitur më datë 15.04.2015, si dhe automjetin targë {\*\*\*}, blerë më datë 27.04.2015, duke qenë se ato kanë shërbyer si burim për krijimin e njëri-tjetrit, trupi gjykues çmoi t’i marrë në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me to sipas rendit kronologjik të transaksioneve të kryera për këto automjete.

**20.1.** Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues mori në shqyrtim fillimisht pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me automjetet e mëparshme të tjetërsuara, konkretisht automjetin me targë {\*\*\*}, të blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003, në vlerën 200.000 lekë, dhe automjetin {\*\*\*}, të blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2009, në vlerën 9.000 euro.

**20.2.** Lidhur me këto dy automjete, Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të këtyre pasurive të luajtshme, ka arritur në konkluzionet si vijon:

**20.2.1.** Në lidhje me automjetin {\*\*\*}, nuk provohet ligjshmëria e të ardhurave nga shitja (pagesa e tatimit si e ardhur personale) dhe nuk provohen as deklarohet vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit.

**20.2.2.** Në lidhje me automjetin {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e konkluzionit të Komisionit, si dhe nuk provoi me burime të ligjshme blerjen e automjetit, sipas përcaktimeve të gemës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016. Këtë konkluzion, Komisioni e bazoi në analizën e kryer lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe mbështetur në deklarinimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, duke vlerësuar se, gjatë hetimit administrativ, në pyetësorin nr. 2 dhe në prapësime, subjekti ndryshoi burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke shtuar “kursimet e tij nga pagat”, të cilat vlerësoi të mos i marrë në konsideratë, pasi nuk ishin deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting* si burim krijimi. Në lidhje me të ardhurat nga kredia e marrë në “NOA” ShA, Komisioni ka konsideruar vetëm shumën 535.836 lekë, ndërsa në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit ekzistues, Komisioni ka konsideruar si të ligjshme vetëm vlerën prej 200.000 lekësh.

**20.3.** Në kundërshtimin e konkluzioneve të mësipërme të Komisionit, subjekti ka pretenduar në ankim se:

**20.3.1.** Në lidhje me automjetin me targë {\*\*\*}: (i) kjo pasuri është blerë me çmim okazion dhe ka pasur nevojë për shërbime të konsiderueshme, që janë përballuar me shpenzimet e tij pas blerjes. (ii) në momentin e shitjes, makina ishte në gjendje shumë të mirë dhe, për këtë arsye, blerësi ka ofruar shumën në fjalë, e cila ishte në përputhje me çmimet e tregut në kohën e shitjes, por është në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar shpenzimet e kryera prej tij në lidhje këtë automjet, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, si dhe për faktin se në atë kohë nuk ka qenë subjekt deklarimi dhe nuk ka pasur detyrimin për të ruajtur apo për të deklaruar shpenzime të caktuara në përputhje me legjislacionin e posaçëm dhe as nuk i është kërkuar ndonjëherë që të justifikojë çmimin e shitjes së këtij automjeti; (iii) veprimet juridike të kryera prej tij për shitjen e automjetit janë tërësisht të ligjshme dhe pagesa e tatimit për diferencën e çmimit të shitjes nuk ka qenë ndonjëherë detyrim ligjor në kuptim të legjislacionit për tatimet.

**20.3.2.** Në lidhje me automjetin me targë {\*\*\*}: (i) kjo pasuri është blerë në vitin 2009, me burim të ardhurat nga kredia e marrë pranë institucionit financiar “NOA” dhe të ardhurat nga shitja e automjetit më datë 01.03.2009; (ii) konkluzioni i Komisionit për pamundësinë financiare në vlerën 498.694 lekë, për blerjen e këtij automjeti, është i gabuar, pasi Komisioni, në mënyrë arbitrare, nuk ka konsideruar si të ligjshme shumën prej 230.000 lekësh nga shitja e automjetit në vitin 2009; (iii) edhe në rastin që këto të ardhura nuk do të merreshin parasysh, nëse do të shqyrtohej mundësia kumulative e tij për krijimin e kësaj shume gjatë viteve 2001 – 2010, analiza financiare do të rezultonte pozitive.

**20.4.** Në kuadër të shqyrtimit të këtyre shkaqeve të ankimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, lidhur me kontrollin e ushtruar mbi krijimin e këtyre dy pasurive të llojit “automjet”, konstatoi dhe vlerësoi si vijon:

- Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: “Blerje makine me kontratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 27.10.2003, në vlerën 200.000 lekë. Burimi i të ardhurave: kursimet. Kjo makinë është shitur në datën 01.03.2009, me kontratë noteriale nr. {\*\*\*}, në shumën 430.000 lekë”.

- Referuar shkresave të administruara në dosjen e ILDKPKI-së dhe të Komisionit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRr”) konfirmon se ky automjet nuk rezulton i regjistruar në emër të subjektit.

- Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës se blerja e pasurisë, në shumën prej 200.000 lekësh, në vitin 2003 dhe shitja më pas, në vitin 2009, në vlerën 430.000 lekë, nuk pasqyron situatën reale dhe nuk i përgjigjet ekonomisë së tregut. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se automjeti është blerë me çmim okazion, pasi ka pasur nevojë për shërbime të konsiderueshme, që janë përballuar me shpenzimet e tij. Në momentin e kryerjes së tyre, nuk ushtronte detyrën e prokurorit, prandaj edhe nuk ka pasur detyrimin për deklarim. Për shkak të kohës së largët kur janë kryer këto shpenzime, është në pamundësi për t’i dokumentuar ato.

- Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, po ashtu, ka deklaruar: blerje automjeti me kontratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.04.2009, në vlerën 9.000 euro. Si burim krijimi për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga kredia të “NOA” ShA, si dhe të ardhurat nga shitja e automjetit në datën 01.03.2009. Ky automjet deklarohet i shitur më datë 15.04.2015, në vlerën 2.500 euro. Kjo pasuri është deklaruar edhe në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2013, ku subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në vitin 2010, në vlerën 9.000 euro, me burim hua nga “Opportunity Albania”. Ndërsa, në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi shitjen e automjetit me targa {\*\*\*}, në vlerën 2.500 euro.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaron se nga të ardhurat e lëvruara nga kredia të “NOA” ShA, në shumën prej 972.320 lekësh, vlera prej 535.836 lekësh është përdorur për blerjen e automjetit, ndërsa diferenca për shlyerjen e një kredie ekzistuese. Deklarimi i subjektit konfirmohet edhe nga informacioni i dhënë nga shoqëria “NOA” SHA, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 06.05.2022, paraqitur nga subjekti bashkëlidhur pyetësorit nr. 2.

- Referuar akteve<sup>24</sup> të paraqitura nga subjekti, si dhe dokumentacionit të paraqitur nga DPSHTRr-ja, administruar në dosjen e ILDKPKI-së dhe të Komisionit, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit nuk disponon automjete të regjistruara në emër të tij.

**20.5.** Në analizë të fakteve të konstatuara më sipër, vlerësuar ato në raport me arsyetimin e dhënë në vendimin objekt kontrolli, trupi gjykues, në përfundim të vlerësimit të situatës faktike lidhur me automjetin {\*\*\*}, vëren se Komisioni nuk ka njohur si të ligjshme të ardhurat nga shitja e këtij automjeti në vitin 2009, me arsyetimin se nuk provohet ligjshmëria e tyre, pasi, sipas tij, nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura dhe as nuk deklarohet dhe provohet vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të këtij automjeti nga ana e subjektit të rivlerësimit.

**20.5.1.** Trupi gjykues e vlerësoi këtë qëndrim të Komisionit në konsideratë të legjislacionit të zbatueshëm, sipas të cilit nuk evidentohet/përcaktohet shprehimisht detyrimi për pagimin e tatimit mbi diferencën që vjen nga çmimi i shitjes me atë të blerjes së një pasurie të luajtshme. Gjithashtu, sillet në vëmendje se, sipas dispozitave kushtetuese dhe interpretimit që u është bërë atyre nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese,<sup>25</sup> përcaktimi i të ardhurave “të tatueshme” nuk

<sup>24</sup> Kontrata e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.04.2009; Kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.04.2015.

<sup>25</sup> Në vendimin nr. 16, datë 25.07.2008, të Gjykatës Kushtetuese, është arsyetuar se: “Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe, si të tilla, ato mund të përcaktohen vetëm me ligj”. Shih: [https://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php)

është lënë në diskrecion të organeve ligjzbatuese, por i është njohur vetëm ligjit. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se ndryshimi që ka pësuar ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me miratimin e ligjit nr. 9161, datë 18.12.2003, sipas të cilit, në nenin 8 të tij, që përcakton të ardhurat e tatueshme, u shtua një paragraf me përmbajtje: g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë – nuk duhet t’i nënshtrohet një interpretimi të zgjeruar, me rezultat përcaktimin e detyrimit për pagesën e tatimit për të ardhurat e krijuara, si pasojë e transaksioneve të shitblerjeve të automjeteve në kushtet e paqartësisë lidhur me shkallën tatimore, bazën e tatueshme, mënyrën e pagesës dhe agjentin tatimbledhës. Përveç sa më sipër, trupi gjykues mori në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, lidhur me përcaktueshmërinë e këtij detyrimi të pasqyruar në shkresën nr. {\*\*\*} prot., të datës 25.05.2023, përcjellë në përgjigje të kërkesës së Kolegjit për informacion. Në këtë dokument pasqyrohet qëndrimi i këtij institucioni se, për qëllim të tatimit të të ardhurave personale, neni 8 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave, i miratuar në zbatim të tij nr. 5, datë 30.01.2006, i ndryshuar, nuk ka të përfshirë dhe/ose cituar si të ardhura të tatueshme, të ardhurat nga shitja e pasurisë së luajtshme (automjet për përdorim personal). Sa më sipër, konkluzioni i Komisionit se këto të ardhura nuk janë të ligjshme, për shkak të mospagimit të tatimit, vlerësohet i pambështetur në ligj.

**20.5.2.** Në drejtim të konkluzionit tjetër të arritur nga Komisioni, lidhur me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, trupi gjykues vlerëson se Komisioni e ka konstatuar drejt situatën faktike sa i takon automjetit me targë {\*\*\*}, i cili rezulton të jetë blerë në vitin 2003, në vlerën prej 200.000 lekësh, dhe shitur në vitin 2009, në vlerën 430.000 lekë, pra 230.000 lekë më shumë se vlera e blerjes së tij. Po ashtu, trupi gjykues konstaton se, megjithëse subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se automjeti u shit në atë vlerë, pasi ai kishte kryer shpenzime riparimi dhe mirëmbajtje, ky pretendim mbeti deklarativ, pasi ai nuk arriti të dokumentojë shpenzimet e kryera prej tij në lidhje me këtë automjet. Pavarësisht sa më lart, në konsideratë të faktit se kjo pasuri është krijuar dhe shitur gjatë periudhës kur subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt deklarues, e për rrjedhojë, nuk ka pasur detyrim ligjor për deklarimin e blerjes, shpenzimeve të përmirësimit dhe shitjen e kësaj pasurie, dhe gjithashtu Komisioni nuk ka konstatuar mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, trupi gjykues vlerëson se, vetëm fakti se subjekti nuk ka arritur të provojë sipas kërkesave të Komisionit shpenzimet e kryera prej tij për riparimin dhe përmirësimin e këtij automjeti, nën dritën e detyrimeve ligjore, vlerësohet se është i pamjaftueshëm, për të arritur në konkluzionin se nuk provohet ligjshmëria e të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie. Mbështetur në sa më sipër, në ndryshim nga Komisioni, trupi gjykues i konsideron të ligjshme të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit {\*\*\*}, në vlerën e plotë sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*}, datë 01.03.2009.

**20.6.** Lidhur me automjetin tjetër, me targë {\*\*\*}, blerë në vitin 2009, në vlerën 9.000 euro, trupi gjykues konstaton se, në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 430.000 lekë, si dhe të ardhurat nga huaja e marrë nga “NOA” ShA, në datën 09.04.2009. Në lidhje me kredinë e përfituar nga “NOA” ShA, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nga shuma totale prej 972.320 lekësh, e lëvruar prej kësaj kredie, vlera prej 535.836 lekësh është përdorur për blerjen e automjetit, ndërsa diferenca është përdorur për shlyerjen e

një kredie ekzistuese. Gjatë shpjegimeve të dhëna në pyetësonin nr. 2, si dhe në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se si burim, përveç sa më lart, kanë shërbyer edhe kursimet e tij nga punësimi.

**20.7.** Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, rezulton se si burim krijimi, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2009, si dhe kredinë nga shoqëria “NOA” ShA, dhe vetëm pasi Komisioni ka kërkuar sqarime në lidhje me përdorimin e të ardhurave nga kredia, në përgjigje të pyetësonit nr. 2, ai ka deklaruar se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer edhe të ardhurat nga paga pranë shoqërisë “NOA” ShA, duke shtuar një burim tjetër në lidhje me këtë pasuri. Sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit në lidhje me këtë burim të deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit, jo vetëm për shkak se ky burim nuk është deklaruar më parë nga subjekti si burim, por edhe sepse, referuar faktit se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt deklarues në vitin 2009, ky fakt e bën të pamundur verifikimin e mundësisë nëse ai në vitin 2009 kishte kursime nga të ardhurat nga paga. Po ashtu, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se ka pasur mundësi kursimi, të cilat i ka përdorur për blerjen e automjetit, nuk është në harmoni me faktet e tjera të parashtruara prej tij gjatë hetimit administrativ, për sa rezultoi e pranuar se ai, në vitin 2009, mori një kredi nga shoqëria “NOA” ShA, e cila shërbeu pjesërisht për shlyerjen e një kredie ekzistuese, ndërsa pjesa tjetër u përdor për blerjen e automjetit objekt shqyrtimi. Në këto kushte, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit, për të mos i konsideruar si burim krijimi për këtë automjet të ardhurat e pretenduara si kursime gjatë viteve.

**20.8.** Trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, në konsideratë të konkluzionit të arritur më lart në këtë vendim, lidhur me konsiderimin si të ligjshme të të ardhurave nga shitja e automjetit {\*\*\*}, të cilat janë deklaruar nga subjekti si burim për krijimin e automjetit me targë {\*\*\*}, konstaton se subjekti i rivlerësimit rezultoi me balancë negative për krijimin e kësaj pasurie, në vitin 2009, në vlerën (- 268.694 lekë), më e ulët se vlera e konstatuar nga Komisioni në vendim, megjithatë ai nuk arriti të justifikojë krijimin e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme.

**20.9.** Pavarësisht sa më lart, trupi gjykues e gjeti të padrejtë konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë e luajtshme “automjet” i tipit “Mercedes-Benz”, me traga {\*\*\*}, të blerë prej subjektit në vitin 2009. Ndonëse nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Kolegj, rezultoi një balancë negative, më e ulët se ajo e Komisionit në momentin e krijimit të kësaj pasurie, në vlerën prej (-) 268.694 lekësh, për sa kohë kjo pasuri nuk vjen si pasuri e subjektit në deklaratën *vetting*, si dhe është krijuar prej tij në një kohë që ai nuk ka qenë në asnjë funksion shtetëror, vlerësohet se nuk mund të kualifikohet si mungesë burimesh për krijimin e pasurisë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**21.** Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit, sa i takon pasurisë së luajtshme “automjet” i tipit “DaimlerChrysler”, me targa {\*\*\*}, blerë nga djali i subjektit të rivlerësimit, në vitin 2015, për të cilën subjekti pretendoi se ka paraqitur prova të mjaftueshme, sipas të cilave provohet mundësia e djalit të tij për të justifikuar me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues vëren dhe vlerëson si vijon:

**21.1.** Komisioni kreu analizën financiare mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie mbështetur në deklaratimet e djalit të subjektit, në deklaratën *vetting*, në të cilën përfshiu vetëm të ardhurat e djalit nga paga, duke mos konsideruar të ardhurat nga bonuset dhe shpërblimet, me argumentin

se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim “DPT”) dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në vijim ISSH), nuk kanë konfirmuar pagesat e tatimit mbi të ardhurat e përfituara prej tij nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në formën e shpërblimit dhe po ashtu ka arsyetuar se, edhe nëse do të vërtetohej pagesa e tatimit me vërtetim nga DPT-ja, këto të ardhura, të cilat janë përfituar në vitet 2013 – 2014<sup>26</sup>, nuk janë deklaruar si kursime nga ana e djalit të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, po ashtu, nuk përfshiu në analizën financiare për këtë pasuri të ardhurat nga shitja e automjetit në pronësi të subjektit, në vlerën 2.500 euro, me arsyetimin se nuk është arritur të provohet burimi i ligjshëm i krijimit të tij. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj pasurie, edhe pas përgjigjeve të rezultateve të hetimit, Komisioni i qëndroi analizës financiare në të cilën përfshihen vetëm të ardhurat nga paga e djalit të subjektit për periudhën 01.01.2015 deri më 27.04.2015, sipas së cilës, djali i subjektit rezultoi me mungesë të burimeve financiare në vlerën prej (-) 318.872 lekësh, për blerjen e këtij automjeti.

**21.2.** Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi përfundimin e arritur nga Komisioni në lidhje me këtë automjet, duke pretenduar se: (i) Arsyetimi i Komisionit është sipërfaqësor dhe ka qëllim që të rrisë sa më shumë balancën negative, për të gjetur shkaqe justifikuese për vendimmarrjen e shkarkimit të tij nga detyra. (ii) Mosnjohja e çmimit të shitjes së automjetit të tij, vetëm për faktin se (nuk) njohin diferencën e çmimit të shitjes, nuk mund të vijojë me logjikën e mëpasshme, se djali i tij nuk ka pasur burime të mjaftueshme për të blerë automjetin në pronësi të tij; (iii) Subjekti ka arritur të provojë burimin e të ardhurave nga punësimi i djalit të tij pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën nëntor 2011 deri në momentin e blerjes së automjetit dhe, po ashtu, edhe shpërblimet e përfituara prej tij nga kjo marrëdhënie punësimi. (iv) Komisioni ka gabuar, duke mos marrë parasysh të ardhurat nga punësimi dhe shpërblimet e përfituara nga djali i tij, nga marrëdhënia e punësimit, dhe as nuk analizoi mundësitë financiare të të gjithë familjes, për të kuptuar nëse ata kishin mundësi që, në mënyrë kumulative, të blinin këtë automjet. (v) Të ardhurat nga shpërblimet nuk konfirmohen nga DRT-ja dhe ISSH-ja për shkak se tatimi i mbajtur në burim në lidhje me këto të ardhura është deklaruar për të gjithë punonjësit dhe jo në mënyrë nominative dhe, për këtë arsye, nuk pasqyrohet pagesa e detyrimeve në emër të çdo individit të regjistruar pranë Tatimeve dhe Sigurimeve Shoqërore.

**21.3.** Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet në fashikullin e Komisionit, konstatoi se në deklaratën e pasurisë *vetting*, djali i subjektit deklaroi se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit të subjektit, sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.04.2015, si edhe kursimet e tij. Referuar DIPP-së së vitit 2015, djali i subjektit të rivlerësimit deklaroi blerjen e automjetit me të ardhura nga shitja e automjetit të subjektit, sikurse pasqyruar në deklaratën e vetë subjektit dhe, po ashtu, në të njëjtën deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e automjetit në pronësi të tij, në shumën 2.500 euro, dhe dhurimin e kësaj shume të birit, së bashku me shumën prej 100.000 lekësh nga kursimet. Po ashtu, deklarohet se të dyja shumat kanë shërbyer për blerjen e automjetit me targë {\*\*\*}.

**21.4.** Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit, lidhur me këtë pasuri të krijuar nga djali i subjektit të rivlerësimit, është ngushtësisht i lidhur me konkluzionin për automjetin {\*\*\*}, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer si burim krijimi për automjetin objekt shqyrtimi. Bazuar në analizën e burimeve të krijimit të automjetit me targë

---

<sup>26</sup> Në DIPP-në e vitit 2013, djali i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar shpërblim nga kompania “{\*\*\*}” ShPK, datë 24.12.2013, në shumën 900.000 lekë dhe në DIPP-në e vitit 2015 deklaroi shpërblim nga kompania “{\*\*\*}” ShPK, në shumën 720.000 lekë neto.

{\*\*\*}, të kryer në Kolegj, në ndryshim nga Komisioni, subjekti rezulton në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në vlerën prej (-) 268.694 lekësh.

**21.5.** Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, gjithashtu, duhet të mbahet në konsideratë fakti se, megjithëse subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm për krijimin e automjetit me targë {\*\*\*}, duke u gjendur në kushtet pamundësisë për krijimin e kësaj pasurie në vlerën (-) 268.694 lekë, ai gjithsesi nuk ishte në kushtet e mungesës së plotë të burimeve për krijimin e saj, pasi, referuar analizës financiare të Komisionit, si dhe nga kontrolli i kësaj analize në Kolegj, provohet se për krijim e kësaj pasurie në vitin 2009 ishin përdorur si burim të ardhurat nga shitja e automjetit ekzistues, në masën 200.000 lekë, si dhe një kredi nga shoqëria “NOA” ShA, në shumën 535.836 lekë, të cilat u konsideruan si burime të ligjshme. Në këto kushte, për sa kohë nga ana e Komisionit, si dhe në Kolegj konfirmohet ekzistenca e një pjese të çmimit të blerjes me burime financiare të ligjshme, si dhe duke shtuar këtu faktin se ky automjet është shitur në vitin 2015, në një vlerë disa herë më të vogël se çmimi i blerjes, pra nuk është shitur me fitim nga ana e subjektit, duket e arsyeshme që shuma 2.500<sup>27</sup> euro, nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*}, në vitin 2015, të konsiderohet si burim për blerjen e automjetit me targë {\*\*\*}, nga djali i subjektit të rivlerësimit, në të njëjtin vit.

**21.6.** Sa më sipër, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, duke përdorur konkluzionin e mësipërm, rezulton se djali i subjektit të rivlerësimit ka balancë pozitive për periudhën 01.01.2015 – 27.04.2015, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, për një mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 318.872 lekë.

**21.7.** Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit, se si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga paga të djalit të tij, si dhe shpërblimet/bonuset nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues vëren se, referuar arsyetimit të Komisionit në vendim, si dhe tabelës së analizës financiare të kryer për pasurinë objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni ka njohur vetëm të ardhurat e djalit nga punësimi për periudhën 01.01.2015 – 27.04.2015, pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, duke mos konsideruar shpërblimet/bonuset e përfituara nga djali i subjektit të rivlerësimit nga kjo shoqëri, me arsyetimin se DPT-ja dhe ISSH-ja nuk konfirmuan pagesën e detyrimeve tatimore. Në lidhje me këto të ardhura, trupi gjykues konstaton se, referuar deklarimeve periodike vjetore 2013 dhe 2014, rezulton se djali i subjektit të rivlerësimit i ka deklaruar të ardhurat në formën e shpërblimeve/bonuseve, të cilat konfirmohen nëpërmjet transaksioneve bankare, si dhe nga vërtetimet e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Referuar ligjit nr. 9920, datë 19.05.2009, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, kjo shoqëri, në cilësinë e punëdhënësit të djalit të subjektit, duke qenë edhe subjekt tatimpagues, ka pasur detyrimin dhe përgjegjësinë për mbajtjen dhe pagesën e kontributeve e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi (pjesë e tatimit mbi të ardhurat personale) për çdo të punësuar. Kësisoj, pavarësisht se nga subjekti nuk u arrit të provohej pagesa e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga djali i tij, nga shpërblimet, situata e përshkruar më sipër vlerësohet se e zhvesh subjektin dhe personin e lidhur nga përgjegjësia, pasi, duke qenë në një marrëdhënie punësimi, ekziston premisa që djali i subjektit të ketë qenë në kushtet e mirëbesimit për mbajtjen

---

<sup>27</sup> Ekuivalenti i shumës 2.500 euro, sipas kursit të këmbimit, sipas publikimit në faqen zyrtare të BSH-së, datë 15.04.2015, është ai i pretenduar nga SR-ja: 1 euro=140.24 lekë, ndërsa ekuivalenti në lekë i vlerës 2.500 euro, sipas këtij kursi, është 350.600 lekë, sikurse pretenduar nga SR-ja në prapësime.

në burim të detyrimeve dhe pagesën e tyre pranë organeve tatimore nga punëdhënësi, dhe se kjo nuk mund të provohet për fakte që nuk varen prej tij.

21.8. Pavarësisht sa më lart, trupi gjykues e gjen të bazuar përfundimin e Komisionit për mospërfshirjen e të ardhurave nga bonuset dhe shpërblimet, nga djali i subjektit, si burim për blerjen e pasurisë “automjet”, në vitin 2015, për arsye se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe deklarimeve të djalit të tij, në lidhje me burimet e krijimit të kësaj pasurie, si dhe me mënyrën se si deklarohet kjo pasuri në deklaratën *vetting*. Djali i subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, në DIPP-në e vitit 2015, nuk ka deklaruar se si burim për blerjen e pasurisë kanë shërbyer edhe kursimet e tij,<sup>28</sup> si dhe nuk rezulton që në DIPP-në e vitit 2015 të ketë deklaruar pakësim likuiditeti apo kursimesh, në favor blerjes së kësaj pasurie. Për sa më sipër, trupi gjykues e gjen të pambështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se për blerjen e automjetit në vitin 2015, përveç burimeve të deklaruara,<sup>29</sup> kanë shërbyer edhe të ardhurat e tjera të djalit të tij nga punësimi.

21.9. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjeti të padrejtë konkluzionin e Komisionit edhe lidhur me pasurinë e luajtshme “automjet” i tipit “DaimlerChrysler”, me traga {\*\*\*}, blerë nga personi i lidhur, djali i subjektit të rivlerësimit, në vitin 2015, pasi vlerëson se në burimet e krijimit të kësaj pasurie duhet të ishin përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e automjetit të subjektit të rivlerësimit, në të njëjtin vit, në vlerën prej 2.500 eurosh, situatë e cila shëron mungesën e burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie.

22. Në lidhje me shkakun e ngritur në ankim sa i takon analizës financiare për periudhën gusht 1995 – maj 2000, trupi gjykues konstaton si vijon:

22.1. Lidhur me analizën financiare për periudhën gusht 1995 – maj 2000, gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe, më pas, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë, Komisioni arriti në konkluzionin se rezultati i analizës financiare të subjektit është në vlerën negative totale prej (-) 2.449.229 lekësh.

22.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se, ndryshe nga sa konkludon me pa të drejtë Komisioni, rezultati i analizës financiare për vitet 1995 – 2000 rezulton me vlerë pozitive, duke evidentuar se: (i) Analiza financiare e hartuar nga Komisioni për vitin 1995 rezulton pozitive në vlerën 653.117 lekë, por kjo shumë pozitive nuk kalon e mbartur në vitin 1996. (ii) Në vitin 1996 nuk janë llogaritur në mënyrë të plotë të ardhurat nga fondacioni “{\*\*\*}”, të cilat janë në shumën 1.220.000 lekë, vërtetuar sipas 4 mandatpagesave të konfirmuara me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.07.2022, të Ministrisë së Financave. (iii) Në vitin 1996 ka deklaruar 1.100.000 lekë shpenzime për ndërtimin e shtëpisë, ndërsa në analizën financiare të Komisionit, kjo shumë është llogaritur në masën 1.533.553 lekë. (iv) *Në vitin 1997 futet në analizë financiare në mënyrë dashakeqe shuma prej 3.500.000 lekësh, ndërkohë që në këtë vit, shpenzimet e deklaruara kanë qenë 2.000.000 lekë, nëse KPK-ja ka marrë parasysh përgjigjet e pyetësorit nr. 2, siç shprehet në vendim. Kjo shumë e përfshirë në vitin 1998 është krejtësisht arbitrare, pa asnjë bazë faktike dhe vetëm heqja e diferencës prej 1.500.000 lekësh, të shtuar*

<sup>28</sup> Referuar kontratës noteriale për shitjen e mjetit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.04.2015, çmimi i kontratës prej 450.000 lekësh deklarohet i paguar tërësisht nga pala blerëse, por nuk referohet mënyra e pagesës.

<sup>29</sup> Të ardhurat nga paga për vitin 2015 dhe nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*}.

*arbitrarisht nga ana e Komisionit në tabelë, e nxjerr diferencën pozitive me mbi 1.000.000 lekë<sup>30</sup>; (v) Në vitin 1998, diferenca sipas përlllogaritjeve të Komisionit del (-) 642.057 lekë, ndërkohë që nuk llogaritet fare diferenca pozitive nga viti i mëparshëm, gjë që do të nxirrte edhe këtë vit me bilanc pozitiv. (vi) Shpenzimet e jetesës për vitet 1995 – 1997 janë përlllogaritur a priori, pa ndonjë referencë ligjore, akt ligjor apo administrativ publik, që përcakton sa duhet të jenë shpenzimet minimale mujore për një familje me 6 anëtarë, të cilat janë “fryrë” në mënyrë të padrejtë nga ana e Komisionit, pasi në këto vite, fëmijët kanë qenë të mitur dhe shpenzimet e tyre nuk mund të përlllogariten njëjloj si për një person madhor.*

**22.3.** Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollloi analizën financiare të kryer nga Komisioni mbi bazën e shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, sipas së cilës rezultoi se Komisioni nuk ka përlllogaritur në analizën financiare për periudhën 1995 – 2000, balancat pozitive të çdo viti që kanë rezultuar ose rezultojnë pas korigjimeve të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Në vlerësim të sa më sipër, për sa kohë kjo analizë përfshin periudhën para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9049/2003, si dhe në mungesë të deklarimit të gjendjes *cash* për çdo vit, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues e vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit, se analiza financiare për këtë periudhë duhet të kryhet në mënyrë kumulative.

**22.4.** Në lidhje me pretendimet e subjektit, sa i takon të ardhurave nga fondacioni “{\*\*\*}”, trupi gjykues konstaton se, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti ka paraqitur 4 mandatpagesa<sup>31</sup>, të cilat rezultojnë të jenë deklaruar si burim krijimi për ndërtimin e pasurisë “shtëpi banimi”, ndër të cilat, 3 prej tyre, i përkasin vitit 1995 dhe janë deklaruar si burim krijimi i pasurisë në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, shitur në vitin 1997, të ardhurat nga shitja janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim për ndërtimin e pasurisë “shtëpi banimi”.

**22.4.1.** Gjatë hetimit administrativ, me përgjigjet e pyetësori nr. 2, subjekti ka bashkëlidhur disa mandatpagesa shtesë<sup>32</sup> dhe, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shtuar edhe mandatpagesën nr. {\*\*\*}, datë 14.10.1996, me vlerë 210.000 lekë, në emër të B. B. Referuar akteve në fashikull rezultojnë se Komisioni i është drejtuar Ministrisë së Financave për informacion në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nga fondacioni “{\*\*\*}”. Në përgjigje të kërkesës<sup>33</sup> së Komisionit për informacion, Ministria e Financave, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 03.06.2022, ka informuar se disponon një numër të kufizuar dokumentesh për kreditorët e fondacionit “{\*\*\*}”, megjithatë ka konfirmuar se mandatet e përcjella nga subjekti janë mandate të dala nga ky fondacion<sup>34</sup>.

<sup>30</sup> Sipas ankimit të subjektit të rivlerësimit në f. 29-30.

<sup>31</sup> Mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, vlera 500.000 lekë, mandatpagesë nr. s'ka, datë 03.07.1995, vlera 37.600 lekë; mandatpagesë nr. s'ka, datë 22.11.1995, vlera 600.000 lekë, mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 30.08.1995, vlera 37.600 lekë. Këto mandatpagesa janë deklaruar si burim për ndërtimin e banesës në Tiranë dhe janë konsideruar edhe nga ana e Komisionit.

<sup>32</sup> Mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 29.03.1996, vlera 32.000 lekë, mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 03.12.1996, vlera 288.000 lekë, në emër të H., A., D. B., mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 03.12.1996, vlera 192.000 lekë.

<sup>33</sup> Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 31.05.2022, drejtuar MFE-së, Shoqërisë Huamarrëse në Administrim. Komisioni i ka bashkëlidhur edhe disa mandatarkëtime të depozituara nga subjekti.

<sup>34</sup> Bashkëlidhur kësaj shkrese gjenden: mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 14.10.1996, vlera 210.000 lekë, në emër të B. B.; mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 03.12.1996, vlera 192.000 lekë, në emër të Bajram Breçani; mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, vlera 500.000 lekë, në emër të Bajram Breçani, mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 29.03.1996, vlera 32.000 lekë, në emër të Bajram Breçani, mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 03.12.1996, vlera 288.000 lekë, në emër të H., A. dhe D. B.

22.4.2. Referuar rezultateve të hetimit, rezulton se Komisioni nuk ka konsideruar në analizën paraprake mandatpagesën nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, me vlerë 500.000 lekë, nga fondacioni “{\*\*\*}”, me argumentin se nuk u arrit të provohej përfitimi i tyre dhe shlyerja e detyrimeve tatimore për vlerën e fituar nga ky investim monetar, si dhe për shkak se këto të ardhura nuk u arritën të konfirmoheshin nga Ministria e Financave për shkak të mungesës së dokumentacionit provues nga ana e tyre. Megjithatë, Komisioni ka konsideruar si të ligjshme të ardhurat nga shitja e apartamentit të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, deklaruar në deklaratën *vetting*, si burim krijimi për pasurinë “shtëpi banimi”, origjina e burimit të krijimit të të cilit është deklaruar në të njëjtën deklaratë nga të ardhurat e tërhequra prej subjektit në fondacionin “{\*\*\*}”, në shumën 675.200 lekë, sipas mandatpagesave të datave 22.11.1995, 03.07.1995 dhe 30.08.1995, bashkëlidhur deklaratës *vetting*.

22.4.3. Me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit dhe në ankim, subjekti ka pretenduar se duhet të njihen të gjitha të ardhurat nga fondacioni “{\*\*\*}”, sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 14.07.2022, të Ministrisë së Financave, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, drejtuar subjektit të rivlerësimit<sup>35</sup>.

22.4.4. Referuar konkluzionit përfundimtar, si dhe analizës financiare të Komisionit në vendim, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka njohur si të ardhura të ligjshme shumën prej 1.175.200 lekësh (500.000 lekë sipas mandatpagesës nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, si dhe shumën 675.200 lekë, sipas mandatpagesave: nr. *s'ka*, datë 22.11.1995, vlera 600.000 lekë, nr. *s'ka*, datë 03.07.1995, vlera 37.600 lekë dhe mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 30.08.1995, vlera 37.600 lekë,<sup>36</sup> duke i reflektuar edhe në analizën financiare për periudhën gusht 1995 – maj 2000, me arsyetimin se si përfundim ka mbajtur në konsideratë mandatpagesat e përcjella në Komision dhe të deklaruara në deklaratën *vetting*, duke mos analizuar më tej në lidhje me mandatpagesat e tjera të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit. Nga verifikimi i deklaratimeve të subjektit në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2013, trupi gjykues e gjen të bazuar konstatimin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar të gjitha të ardhurat nga fondacioni “{\*\*\*}”, dhe se në këtë deklaratë rezulton të jenë deklaruar vetëm mandatpagesa nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, si dhe mandatpagesat datë 03.07.1995, datë 22.11.1995 dhe datë 30.08.1995, si burim krijimi për pasurinë “shtëpi banimi”, me sipërfaqe 145 m<sup>2</sup>, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni.

22.4.5. Pavarësisht pasaktësisë në deklaram, rezulton se gjatë hetimit në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa mandatpagesa të njësuara me origjinalin, të cilat konfirmohen nga Ministria e Financave sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 14.07.2022, ndër të cilat, tri prej tyre

---

<sup>35</sup> Mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 14.10.1996, vlera 210.000 lekë, në emër të B. B.; mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 03.12.1996, vlera 192.000 lekë, në emër të Bajram Breçani; mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 20.07.1996, vlera 500.000 lekë, në emër të Bajram Breçani, mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 29.03.1996, vlera 32.000 lekë, në emër të Bajram Breçani, mandatpagesë nr. *s'ka*, datë 22.11.1995, vlera 600.000 lekë, në emër të Bajram Breçani; mandatpagesë nr. *s'ka*, datë 03.07.1995, vlera 37.600 lekë, në emër të Bajram Breçani; mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 30.08.1995, vlera 37.600 lekë, në emër të Bajram Breçani dhe mandatpagesë nr. {\*\*\*}, datë 03.12.1996, vlera 288.000 lekë, në emër të H., A. dhe D. B.

<sup>36</sup> Të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurisë “apartament banimi” në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, banesë e cila ka qenë në bashkëpronësi me vëllain tim, B. U. B., me pjesë takuese 50% me 50%, të ardhurat nga shitja e të cilit, sipas kontratës noteriale nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 16.01.1997, në vlerën 2.000.000 lekë, janë konsideruar nga Komisioni në analizën financiare për ndërtimin e banesës.

i përkasin vitit 1995 dhe janë përfshirë në analizën e Komisionit për vitin 1995, së bashku me shumën prej 500.000 lekësh, sipas mandatpagesës së vitit 1996. Mandatpagesat e tjera, të konfirmuara nga e njëjta shkresë, nuk u përfshinë nga Komisioni në analizë, me arsyetimin se nuk ishin deklaruar në deklaratën *vetting*. Nga verifikimi i këtyre mandatpagesave, trupi gjykues konstaton se ajo me nr. {\*\*\*}, datë 14.10.1996, në vlerën 210.000 lekë, i përket vëllait të subjektit, B. B., dhe nuk mund të përlllogaritet si e ardhur në emër të subjektit, ndërkohë që mandatpagesat e tjera konkretisht ato me nr. {\*\*\*}, datë 03.12.1996, vlera 192.000 lekë, me nr. {\*\*\*}, datë 29.03.1996, vlera 32.000 lekë, me nr. {\*\*\*}, datë 03.12.1996, vlera 288.000 lekë, deklarohen për herë të parë gjatë hetimit administrativ. Referuar kësaj situatë faktike, ndonëse nuk përjashtohet mundësia që subjekti i rivlerësimit të ketë përfituar të ardhura nga investimi i kryer pranë fondacionit në fjalë, në kushtet kur Komisioni nuk ka analizuar, si dhe nuk ka kryer kontroll lidhur me mundësitë e krijimit të shumave të investuara nga subjekti i rivlerësimit pranë këtij fondacioni, si dhe referuar faktit se nuk administrohen të dhëna lidhur me vlerën dhe kohën kur janë kryer këto investime, trupi gjykues vlerësoi të mos analizojë më tej, për efekt të analizës financiare lidhur me këto të ardhura.

**22.5.** Sa i takon pretendimeve të tjera të subjektit në lidhje me vlerat e investuara sipas viteve për pasurinë “shtëpi banimi”, trupi gjykues vëren se, në analizën e vitit 1996, Komisioni ka korrigjuar vlerën e investimit të kryer për ndërtimin e banesës, sipas deklaratimit të subjektit të rivlerësimit, në pyetësin nr. 2 dhe, për këtë arsye, pretendimi i subjektit, lidhur me vlerën e përfshirë në analizë, nuk qëndron. Po ashtu, trupi gjykues vëren se, ndryshe nga sa pretendon subjekti, vlera e shpenzuar në vitin 1997, e deklaruar prej tij në pyetësin nr. 2, rezulton rreth 2.500.000 lekë. Në këtë situatë faktike, sikurse sqaruar edhe më lart në këtë vendim, Komisioni ka llogaritur si shpenzime për banesën gjatë viteve 1996 – 1998, vlerën 4.000.000 lekë, si kosto ndërtimi dhe vlerën 1.200.000 lekë, shpenzime për punime të brendshme dhe arredim, në total shumën 5.200.000 lekë, e cila shtrihet në periudhën kur edhe është kryer pjesa më e madhe e investimit, në vitet 1996 – 1998. Pavarësisht këtij konstatimi, trupi gjykues vëren se vlera e alokuar për çdo vit për këtë periudhë nuk sjell ndikim në rezultatin e analizës financiare, pasi analiza për periudhën 1995 – 2000 kryhet sipas metodologjisë kumulative. Sa më sipër, trupi gjykues e gjen të pambështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me shpenzimet për investimet për pasurinë “shtëpi banimi”.

**22.6.** Sa i takon pretendimeve të subjektit në lidhje me shpenzimet e jetesës, trupi gjykues vlerëson se, referuar jurisprudencës së Kolegjit, shpenzimet e jetesës deri në vitin 2000 llogariten në masën 30% të të ardhurave nga paga e magjistratit, ndërsa nga viti 2000 e në vazhdim, sipas standardit të vendosur nga ILDKPKI-ja. Duke qenë se gjatë periudhës 01.09.1995 – 12.05.2000, subjekti ka ushtruar funksionin e hetuesit/prokurorit, shpenzimet e jetesës u përlllogaritën në masën 30% të pagës së tij. Trupi gjykues e vlerësoi të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për ulje të shpenzimeve të jetesës për shkak se fëmijët kanë qenë të mitur, pasi vlerat e përlllogaritura sipas këtij standardi referojnë një nivel minimal në kufirin e mbijetesës. Nga rilllogaritja e kryer sipas vlerësimit të mësipërm, shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit, për periudhën 1995 – 1999, u ulën nga 1.071.577 lekë (llogaritur nga Komisioni), në 801.763 lekë. Nga analiza kumulative për periudhën 1995 – maj 2000, e kryer në Kolegj, duke reflektuar edhe qëndrimin lidhur me shpenzimet e jetesës, bilanci negativ u ul nga (-) 2.449.229 lekë, konstatuar nga Komisioni, në (-) 1.112.177 lekë.

**22.7.** Ndonëse nga kontrolli i kryer nga NJSHL-ja në Kolegj, analiza financiare për periudhën 1995 – 2000 rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive

dhe përballimin e shpenzimeve, trupi gjykues konstatoi se kjo mungesë rezultoi ndjeshëm më e ulët se vlera e përlllogaritur nga Komisioni, për shkak të aplikimit të një metodologjie që kryhet në mënyrë kumulative për këto vite, për të cilat nuk ka deklarime periodike të subjektit, si edhe reduktim të shpenzimeve të jetesës, duke arritur në vlerën prej (-) 1.112.177 lekësh. Në këto kushte, duke konsideruar se ajo i përket periudhës në të cilën subjekti ka krijuar pasurinë “shtëpi banimi”, të analizuar në këtë vendim, dhe është më e ulët se balanca negative, e cila ka rezultuar për krijimin e saj, vlerësohet se kjo analizë e trajtuar nga Komisioni, si një shkak më vete për aplikimin e masës disiplinore, është e padrejtë, duke qenë se ajo dublon dhe diktohet pikërisht nga shpenzimet e kryera për financimin e kësaj pasurie. Në këto rrethana, trupi gjykues e gjeti pa peshë përcaktuese, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit, analizën financiare të kryer nga Komision për këtë periudhë kohore.

23. Në situatën e mësipërme, trupi gjykues analizoi balancën negative të konstatuar për krijimin e pasurisë “shtëpi banimi”, në vlerën prej (-) 1.933.800 lekësh, si e vetmja balancë negative e konstatuar, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke konsideruar një sërë rrethanash si më poshtë, por jo vetëm: (i) Pasuria e krijuar me mungesë të burimeve të ligjshme daton të jetë krijuar në vitet 1996 – 1998, kohë në të cilën informaliteti ishte në nivele tepër të larta, përfshi edhe situatën e ekzistencës së firmave piramidale si një realitet jetësor e historik. (ii) Gjatë kësaj kohe, edhe pse subjekti i rivlerësimit ka mbajtur funksionin e prokurorit, nuk ka pasur rregullime ligjore për deklarimin e pasurisë, për pasojë, të dhënat e para në lidhje me këtë pasuri evidentohen në vitin 2013, në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, në një distancë të largët kohore nga koha e ndërtimit të kësaj banese. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar vetëdeklarimit të bërë pranë ALUIZNI-t, në vitin 2006, për sa i përket pjesës takuese, si dhe ka përcaktuar në terma të përgjithshëm burimet e krijimit të saj, të cilat për pasojë mund të kenë pasaktësi në referim, konsideruar edhe faktin se ai në atë kohë nuk ushtronte funksione publike, që e bënin subjekt deklarues, pra nuk presupozohej të kishte një vëmendje të shtuar në vetëdeklarimet nga ky këndvështrim. (iii) Gjendja faktike e ndërtimit të kësaj banese nuk duket se përjashton plotësisht deklarimin e vetë subjektit të rivlerësimit për investimin e tre vëllezërve në 1/3 pjesë takuese të saj, duke qenë se kati i tretë është akoma i papërfunduar dhe struktura e objektit sugjeron për një godinë banimi të dedikuar tri apartamenteve të veçuara. (iv) Pasuria objekt shqyrtimi është pasuria e vetme e subjektit të rivlerësimit dhe problematika e konstatuar lidhur me të mbetet e vetme dhe e izoluar, në periudhën 1996 –1998, dhe nuk evidentohen problematika të tjera në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë për të gjithë periudhën e rivlerësimit (vitet kur subjekti i rivlerësimit është bërë pjesë e sistemit të prokurorisë, 2013 – 2016). (v) Pasuria e subjektit ka mbetur e pandryshuar ndër vite dhe nuk evidentohen përpjekje për të deformuar të vërtetën. (vi) Ndër të tjera, në konsideratë të të dhënave që vijnë nga korrespondenca me Ministrinë e Financës, duket se ka ekzistuar një marrëdhënie e vazhdueshme huadhënie/huamarrje midis subjektit të rivlerësimit/familjes së tij me fondacionin “{\*\*\*}” në vitet 1995 dhe 1996, të cilat japin indicie se subjekti i rivlerësimit mund të ketë përfituar të ardhura të tjera të pretenduara prej tij, ku përveç të ardhurave të deklaruara në deklaratën *vetting* dhe të pranuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit duket të ketë përfituar edhe të ardhura të tjera në shumën 325.000 lekë, të cilat nuk janë bërë pjesë e vlerësimit dhe e analizës nga ana e Komisionit, e që mund të kenë shërbyer për financimin e pasurisë objekt shqyrtimi.
24. Për sa më lart, problematikat e evidentuara lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të vlerësuara në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, sipas parashikimit të

nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e çojnë trupin gjykues në konkluzionin se janë të pamjaftueshme për të mbështetur dhënien e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, duke arsyetuar *a contrario*, se ai arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

25. Në përfundim të këtij shqyrtimi, duke konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, së bashku me konkluzionin e arritur për një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, në këto rrethana, vendimi i Komisionit duhet ndryshuar dhe ai duhet të konfirmohet në detyrë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

- Ndryshimin e vendimit nr. 558, datë 06.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani.

- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 24.04.2025, në Tiranë.

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi – kundër*

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi – kundër*

#### **KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Ne, anëtarët e trupit gjykues, Sokol Çomo dhe Rezarta Schuetz, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kemi votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për ndryshimin e vendimit nr. 558, datë 06.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që shkarkoi nga detyra subjektin e rivlerësimit, z. Bajram Breçani, dhe konfirmimin e tij në detyrë.
2. Komisioni e ka bazuar vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në vlerësimin përfundimtar për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] *Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të paplotë dhe ka mungesë të burimeve financiare lidhur me pasuritë. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për blerjen e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme, në vlerën 2.449.229 lekë. Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasuritë, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. [...] Pra, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti nuk gjendet në kushtet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi deklarimi i pasurive nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin. Në rastin e subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Aneksit të Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.*
3. Në lidhje me pasurinë “shtëpi banimi”, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer *deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë “truall” dhe ndërtimin e objektit (pjesën takuese), duke mos u gjendur në kushtet e përcaktuara në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, subjekti është gjendur në kushtet e përcaktuara nga germa “b” e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare të ligjshme për këtë pasuri.*
4. Në shqyrtim të shkaqeve të ankimit dhe akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, ne kemi qëndrim të kundërt nga shumica e trupit gjykues dhe çojmë se vlerësimi i Komisionit në lidhje me pasurinë “shtëpi banimi” është i mbështetur mbi një analizë të drejtë të situatës faktike në raport me ligjin dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Problematikat e konstatuara nga Komisioni në lidhje me deklarimin e pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në vlerësimin e gjyqtarëve në pakicë justifikonin lënien në fuqi të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin.
5. Në mënyrë të përmbledhur, nga situata faktike, rezulton se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, që Komisioni i kaloi në përfundim të rezultateve të hetimit në lidhje me pasurinë “shtëpi banimi”. Aktet shkresore dhe shpjegimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit mbetën të nivelit deklarativ dhe të pambështetura me dokumentacion justifikues.
6. Subjekti nuk e ka deklaruar përfshirjen e vëllait të tij, A. B., si kontribues në blerjen e pasurisë “truall” dhe ndërtimin e objektit, në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2013 dhe as në

kërkesën e bërë për legalizim pranë ALUIZNI-t, në vitin 2006. Një fakt i tillë është deklaruar për herë të parë në deklaratën *vetting*, mbështetur me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.10.2016, “Për njohje shpenzimesh financiare”, deklaratë e cila, nuk rezulton të ketë gjurmë të depozitimit pranë ndonjë institucioni në vitin 2016, apo të jetë shoqëruar me kërkesë për depozitim e saj pranë ALUIZNI-t, me qëllim ndryshimin e vetëdeklarimit të kryer në vitin 2006, në lidhje me bashkinvestuesit dhe përfshirjen e vëllait tjetër të subjektit, si bashkinvestues/bashkëpronar i kësaj pasurie.

7. Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.10.2016, “Për njohje shpenzimesh financiare”, e përpiluar pak kohë para fillimit të procesit të rivlerësimit dhe pasi ishte miratuar ligji nr. 84/2016, nuk është bindëse dhe duket se është bërë për nevoja të procesit të rivlerësimit, e për rrjedhojë, pa vlerë provuese për situatën faktike në kohën kur është krijuar pasuria objekt kontrolli.
8. Subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën (-) 1.933.800 lekë, konstatuar nga Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, konfirmuar edhe nga analiza financiare e kryer në Kolegj.
9. Kjo mungesë e burimeve financiare të ligjshme përfaqëson pothuajse 50% të vlerës së investuar prej tij për këtë pasuri, e cila, vlerësuar në raport me të ardhurat nga paga, në vlerën 986.654 lekë, për të njëjtën periudhë, 1996 – 1998<sup>37</sup>, përfaqëson një shumë të konsiderueshme, e cila arrin gati sa dyfishi i të ardhurave të subjektit gjatë viteve të investimit dhe dukshëm e papërbalueshme për një familje me 6 anëtarë, ku i vetmi që sillte të ardhura ishte subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, mungesa e burimeve të subjektit vlerësohet të jetë tepër e lartë në raport me kontekstin ekonomik të kohës, pasi kjo mungesë rezulton të jetë afërsisht sa 70 paga mujore neto<sup>38</sup> të subjektit, gjatë periudhës së investimit.
10. Sa më sipër, mungesa e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, krahas problematikave të tjera të konstatuara lidhur me saktësinë e deklarimeve në lidhje me kohën dhe koston e investimit të kryer, duhen konsideruar se e vendosin subjektin në kushtet e mosarritjes së një niveli të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
11. Bazuar në analizën e mësipërme, për ne, gjyqtarët në pakicë, shkarkimi i subjektit të rivlerësimit nga detyra ishte i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për pasojë, vendimi i Komisionit objekt kontrolli duhej të lihej në fuqi.

**GJYQTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

---

<sup>37</sup> Analizuar në mënyrë të detajuar më tabelën e analizës financiare, për periudhën gusht 1995 – maj 2000, në faqen 32 të vendimit të Komisionit.

<sup>38</sup> Paga mesatare neto e subjektit, për periudhën 1996–1998, përllogaritet rreth 27.000 lekë/muaj.